

Dr. Vehbetu Zuhejli

Tradita

IX

Pjesë e shkëputur nga “Usuli fikhu islam”

Autori:
Dr. Vehbetu Zuhejli

Përktheu:
Dr. Musli Vërbani

Titulli:
Tradita

Korrektura:
Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Tradita

Tema e traditës ka rëndësi të posaçme në fushën e fikhut dhe të usulit, duke pasur parasysh se fukahatë bazohen në të për përpilimin e shumë dispozitave të sheriatit, dhe njerëzit të cilët miratojnë ligje të kontratave, shit-blerjeve, të agronomisë dhe të marrëdhënieve reciproke, kur ato i mbyllin sytë në argumentimin me ligjet e sheriatit islam. Paraqitja e rregullave të tërësishme të sheriatit e pranon si argument dhe e zëvendëson deri në atë masë sa që në mendjet e njerëzve në çështjet për të cilat nuk ekziston teksti shihet prej **burimeve të sheriatit**. Kjo nga shkakut se merr përmasa në atë nivel sa që e pranojnë njerëzit dhe i plotëson nevojat ashtu siç sheriatit parasheh lehtësim dhe përkujdeset për parimin *largimi i dëmit dhe i vështirësive*. Kësaj i shtojmë edhe atë se në të bazohet edhe ligji laik, dhe juristët e ligjit islam dhe laik, prokurorët dhe gjyqtarët e marrin për bazë në gjykimin dhe konceptin e gjykimit të tyre.

Temën mund ta analizojmë si në vijim:

Nëntema e parë: Esenca e traditës dhe llojet e tij.

Nëntema e dytë: Kur llogaritet tradita si argument dhe llojet e tij.

Nëntema e tretë: Kushtet të cilat llogariten që tradita të konsiderohet argument dhe dispozita kur bie ndesh me tekstet e sheriatit.

Nëntema e katërt: Rregullat e fikhut të cilat kanë të bëjnë me traditën.

Nëntema e pestë: Kundërthënia e traditës me mendimet e ekspertëve të fikhut.

Për secilën temë do të ketë nëntema dhe çështje të cilat duhet analizuar dhe perceptuar në mënyrë që të arrijmë deri te rezultati përfundimtar në pikat precize por duke mos u marrë me çështjet e dyshimta.

Nëntema e parë: Esenca e traditës dhe zakonit dhe llojet e tyre.

Kjo temë ngërthen në vete disa çështje të cilat patjetër duhet sqaruar për të arritur te pasqyrimi i parë dhe i qartë sepse gjykimi për diçka është dega e pasqyrimit të saj. Kështu do t'i sqarojmë si në vijim:

1. Definicioni i traditës gjuhësisht dhe terminologjisht.

Fjala *traditë* në aspektin gjuhësor ka shumë kuptime, si, *ajo çka më së miri praktikohet dhe çështja më e lartë*. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَعَلَى الْأَعْرَافِ رِجَالٌ

“Dhe mbi earaf janë njerëzit...” (El Earaf : 46)

Kuptimi tjetër është “të pasuarit”. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَالْمُرْسَلَاتِ عُرْفًا

“Pasha erërat që fryjnë një pas një.” (El Murselat : 1)

Pastaj kuptimi “pranim”, si p.sh. thënia: **“Ai e pranon njëqind herë.”** Pastaj “durim” për të treguar qetësimin dhe vazhdimësinë e përhershme.

Në terminologji: shprehia e njerëzve në ndiçka dhe vazhdimësia e tyre ndaj çdo vepre e cila është e përhapur në mesin e tyre ose të ndonjë shprehjeje të cilën e kuptojnë në një kuptim të veçantë të cilën njerëzit e kuptojnë për atë qëllim dhe jo për ndonjë qëllim tjetër.

Ky definicion tregon për traditën veprorë dhe traditën shprehimore.

Tradita veprorë: si p.sh., shprehia e njerëzve për shitblerje vetëm me shenja pa shprehur fjalë të ofrim-pranimit. Pastaj tradita e shoqërisë në ndarjen e meherit në mehrin e menjëhershëm dhe në mehrin e afatizuar. Pastaj shprehia e shoqërisë për të ngrënë oriz ose drithëra ose mish të dashit apo të lopës.

Tradita shprehimore: si p.sh., tradita e shoqërisë që atëherë kur përdoret fjala fëmijë, ka për qëllim fëmijën mashkull dhe jo femër dhe për mishin e peshkut nuk bënë pjesë fjala mish dhe përdorimi i fjalës kafshë bëhet posaçërisht për kalin.

Gazaliu dhe Xharxhaniu dhe të tjerët e definojnë kështu:¹ Ajo çka vulolet në zemrat e njerëzve nëpërmjet mendjeve dhe më pastaj natyrshmëria e shëndoshë e pranon si të tillë.

2. Definicioni i zakonit gjuhësisht dhe etimologjisht.

Gjuhësisht *zakoni* është infinitiv nga fjala e *përsëritjes* (kthyerjes) e që e ka kuptimin e edukimit dhe të vazhdimësisë dhe çdo gjëje e cila bëhet zakon deri sa veprohet pa ndonjë vështirësi. Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Pastaj e bëjnë shprehi (kthehen) në atë që kanë thënë.”**

Në terminologji, *zakon* është çështja e cila përsëritet pa pasur ndërlidhmëni me logjikën.² Lidhshmëria logjike është ajo të cilën logjika e gjykon se përsëritet. Ajo pra është domosdoshmëri logjike dhe nuk është zakonore, shembull, paraqitja e gjurmës me gjurmimin e gjurmuesit. Pastaj, lëvizja e unazës me lëvizjen e gishtit.

Ndryshimi i një çështje prej një vendi në vendin tjetër nuk quhet zakon, sado që përsëritet, sepse logjika e gjykon ashtu për shkak të lidhshmërisë së të shkaktuarës me shkaktuesin.

3. A ka dallim në mes të traditës dhe zakonit, dhe nëse ka, cili është ai dallim?

Disa usulistë mendojnë se fjala traditë dhe zakon janë sinonime të njëra-tjetrës, si p.sh., dijetari Neseñij i Hanefijëve, pastaj ibni Abidijn, pastaj Zahariju i cili është autori i librit “Sherhul menar”, ibn Nexhmi në librin “El Eshbahu ven-nedhair”.³ **Këta i kanë dhënë kuptimin: Çështje e thelluar në zemra, në vepra ashtu edhe në fjalë, të cilën e pranojnë natyrshmëria e shëndoshë dhe logjika.** Në këtë nuk ka dallim në mes të asaj se logjika është pjesë e asaj dispozite, si p.sh., ndërrimi i vendit në lëvizje apo të asaj se logjika nuk është pjesë e asaj dispozite si f.v., minimumi i menstruacionit apo maksimumi i saj. Kjo sipas drejtimit të pastër teorik i cili buron nga perceptimi gjuhësor dhe terminologjik dhe përputhshmëria me dispozitën e cila miratohet me ta.

Disa usulistë tjerë si p.sh., Hemami, Bezdaviju dhe autori i librit “et-Telvijh”⁴ japin mendimin se **tradita është më gjithëpërfshirëse se zakoni:**

- Tradita përfshin edhe shprehjet edhe veprimet, përderisa
- zakoni përkufizohet vetëm në traditën e veprimeve.

Grupi i tretë i dijetarëve mendon se zakoni është më gjithëpërfshirës se tradita, si f.v., Ibn Emirë el Haxh dhe të tjerët të cilët pajtohen me të, të cilët janë prej hadithologëve, si f.v., shejh Ahmed Fehmi Ebi Sene,⁵ i cili mendon se **tradita përfshinë atë e cila burimin e ka nga logjika**, si f.v., lëvizja e unazës bëhet me lëvizjen e dorës, apo çështjeve natyrore, si f.v., menstruacioni, shtatzënia, nxehtësia e vendit dhe ftohja e saj, por edhe me atë e cila nuk ka ndërlidhmëni me logjikën, prej fjalëve apo veprave, e të cilat burojnë nga individit apo shoqëria. Traditat personale të ushqimit dhe fjetjes, dhe tradita shoqërore e mirë apo e keqe, si gëzimi në festa e dasma, në festa kombëtare dhe festa shoqërore dhe përdorimi i disa fjalëve për ndonjë kuptim të caktuar dhe ndërveprimi në disa veprimtari dhe kontrata si f.v., dhuratat e fejesave dhe porositja e prodhimeve të caktuara.

Drejtimi i grupit të dytë dhe tretë përkufizohen në kuptimin gjuhësor dhe përdorimin e fjalës për ndonjë kuptim të caktuar. Kjo është e saktë sa i përket mënyrës së përdorimit dhe asaj që secila fjalë përdoret për kuptim të caktuar.

Drejtimi i tretë është më përkufizues sepse sipas tyre **zakoni është më gjithëpërfshirës se tradita**.

Përderisa, sa i përket fushës së usuli fikhut, e cila për këndvështrim ka përpilimin e ligjeve për diçka ose të argumentuarit me atë argument, që do të thotë se, tradita dhe zakoni kanë të njëjtin kuptim karshi të llogariturit si burim i sheriatit.

Sa i përket dijetarëve të ligjit laik, ata bëjnë dallimin në mes të traditës dhe zakonisht. Traditës ia parashohin dy kushte:

E para: Që njerëzit ta bëjnë shprehje që në mes vete të veprojnë në një mënyrë të caktuar për një çështje të caktuar.

E dyta: Të plotësuarit e elementit që ta veprojnë domosdoshmërisht atë shprehje.

Burimi i zakonit dhe traditës

Zakoni buron prej çështjeve që njeriu ndjen qetësi teksa i vepron dhe prej çështjeve të cilat shtyhen nga ndjenjat e brendshme si f.v., paraqitja e dobisë së një çështjeje, apo të vepruarit e një çështje dhe pastaj përsëritja e atij veprimi bëhet shprehje.

Tradita buron nga shprehia e ndërsjellë e njerëzve mes vete dhe përsëritja e asaj shprehie bëhet aq e shpeshtë sa që përhapet në mes të individëve të shumtë të shoqërisë. Në të vërtetë tradita është zakoni shoqëror.⁶

1. Dallimi në mes të traditës dhe ixhmait.

Ixhmai ndërtohet nga unifikimi i muxhtehidëve të umetit të Muhamedit s.a.v.s., e kjo pas vdekjes së tij, në një epokë prej epokave, për një dispozitë të sheriatit. Nuk mund të aprovohet pa pasur mbështetje në argumente të sheriatit, e cila mund të arrihet por edhe mund të mos arrihet (themelohet). Ixhmai është argument i domosdoshëm.

Sa i përket traditës, ajo është veprimtaria e shumicës, e që në atë shumicë bëjnë pjesë dijetarët dhe njerëzit e rëndomtë. Nga ky aspekt, kjo i ngjanë historisë dhe nuk është kusht unifikimi i të gjithëve dhe nuk kërkohet që të ketë bazë të sheriatit dhe nuk ka fuqi argumentuese të përgjithmonshme sepse mund të jetë e drejtë por mund të jetë edhe jo e drejtë. Papajtueshmëria është bazë e kësaj force dhe: A është dëshirë për ligjvënje, apo gjykim i gjyqtarit, apo thjesht unifikim i njerëzve?⁷

2. Tradita nga aspekti i përmbajtjes.

Tradita ndahet sipas aspekteve të ndryshme, si:

Nga aspekti i përmbajtjes ndahet në:

- Traditë shprehimore; dhe
- Traditë vepruese.

Nga aspekti i realizimit ndahet në:

- Traditë e përgjithshme; dhe
- Traditë e veçantë.

Nga aspekti legjislativ ndahet në:

- Traditë e shëndoshë; dhe
- Traditë jo e shëndoshë.⁸

Klasifikimi i parë: Nga aspekti i përmbajtjes, tradita ndahet në:

- traditë shprehimore apo foljore dhe
- traditë praktike apo vepruese.

Tradita shprehimore është shprehja e cila përhapet në mesin e shoqërisë për një kuptim të veçantë, e cila është ndryshe nga tregueshmëria gjuhësore dhe kjo ndryshon nga një vend te një tjetër si f.v:

- fjala *dërrhem*, e cila në të shumtën e rasteve përdoret për monedhë edhe pse baza e përdorimit të saj është për monedhën e prodhuar prej argjendi për çdo vend dhe për çdo kohë.

Po ashtu përdorimi i fjalës *fëmijë*, për djemtë, ndërsa në aspektin gjuhësor fjala *fëmijë* është edhe për djem edhe për vajza.

Po ashtu përdorimi i fjalës *mish* për mishin e lopës dhe deleve dhe jo për mishin e peshkut, edhe pse fjala mish tregon për të gjitha llojet e mishrave.

Po ashtu përdorimi i fjalës *shtëpi* për dhomën apo për dhomën e fjetjes, ndërsa fjala shtëpi tregon për vendbanimin, e kjo edhe nëse është në pyetje shatori i endacakëve (nomadëve).

Po ashtu përdorimi i fjalës *grua* për gruan e lirë edhe pse gjuhësisht përfshin edhe gruan e lirë edhe robëreshën.

Tradita vepruese: Atë veprim që e bëjnë shprehi njerëzit nga veprimet e rëndomta, si f.v., në ushqim dhe në agronomi dhe në raportet shoqërore si f.v., në shitblerje dhe huadhënie dhe pagesa me këste dhe pushimi në fundjavë. Klasifikimi i mehrit në mehr të menjëhershëm dhe të afatizuar. Shlyerja e borxhit, uzurpimi, pranim-dorëzimi, etj.

E vërteta e këtij klasifikimi është në atë se njerëzit e praktikojnë në atë mënyrë e cila është më e lehtë, më praktike dhe më e leverdishme për ta dhe kjo e ndërton urën e ndërlidhjes dhe shfrytëzimit sa më të mirë të raporteve shoqërore.

3. Tradita nga aspekti i realizimit.

Nga aspekti i realizimit, tradita klasifikohet në traditë të përgjithshme dhe të veçantë.

1. **Tradita e përgjithshme** është tradita e cila përhapet në pjesën më të madhe të vendeve ose në gjithë shoqërinë edhe pse kalon në kohëra dhe vende të ndryshme, si prodhimi i plotësimit të nevojave, si në rroba, veshmbathje, shtrojat, mobilet dhe mjeteve tjera, shitblerja pa shprehjen e ofrim-pranimit, shtyrjen e afatit të mehrit dhe obligueshmëria e dhënies së atij mehri nëse gruaja vdes apo shkurorëzohet, dhe që shërbyesit të shprehin respekt gjatë ofrimit të ushqimit në restorante dhe hotele dhe shfrytëzimi i ujit në banja publike në sasi të pakufizuara, po ashtu edhe të rrymës gjatë qëndrimit në ato hotele, po ashtu edhe marrja e pemëve të cilat bien në tokë të cilat gjenden në rrugë dhe parqe publike.

2. **Tradita e veçantë** është tradita e një vendi të caktuar apo e një grupi të caktuar, si f.v., tradita e një profesioni dhe jo i tjerëve përpos tyre dhe kjo ndryshon me ndryshimin e kohëve, si f.v., tradita e tregtarëve që nëse malli është me ndonjë të metë lejohet kthimi ose prishja e asaj marrëveshje, po ashtu pagesa e mallit të afatizuar për çdo ditë të enjte, shitja e mallit të caktuar, po ashtu pagesa e lokaleve me qira, apo e dhomave në çdo muaj, apo në çdo tre muaj apo në çdo vit, po ashtu rinovimi i aktit të qerasë me të drejtën e fuqisë së ligjit. Pagesa e shërbimit për avokatin me dy këste, kësti i parë në momentin e autorizimit dhe kësti i dytë pas kryerjes së procedurës. Po ashtu edhe terminologjitë për çdo vepër artistike, çdo profesion, dhe çdo lëndë shkencore, pastaj terminologjitë e fikhut dhe shprehjeve vakëfnore.

4. Tradita e vërtetuar me ligj ose varësisht prej pranimit apo mospranimit të tij.

Varësisht se tradita a pranohet apo nuk është e pranuar nga ligji, ajo ndahet në:

- Traditë e drejtë; dhe
- Traditë jo e drejtë.

Tradita e drejtë është ajo të cilën njerëzit e marrin si traditë, por që nuk bie ndesh me ligjin (shariat) dhe as nuk e lejon të ndaluarën dhe nuk e ndalon të lejuarën, si p.sh.,

- dhënia e paradhënies në rastin e kontraktimit të mallit të porositur,
- dhurimi i dhuratave në fejesa;
- tradita që të mos i paguhet gruas një pjesë e mehrit;
- tradita që mehri të mund të ndahet në mehër të menjëhershëm dhe në mehër të afatizuar;
- gjykimi në bazë të traditës në përbetime dhe në shkurorëzim dhe pranimi i mallit pas dorëzimit apo bartjes, dhe
- shprehjet në shitblerje, dhurata, namaz, zekatë dhe haxh, numërimi i shkurorëzimeve, dhe vdekjes, e të ngjashme.

Tradita jo e drejtë, është ajo që njerëzit e marrin për traditë, por që ajo traditë ose e lejon të ndaluarën, ose e ndalon të lejuarën, si f.v.,

- tradita e disa kredive kamatare,
- të vepruarit me veprime të shitblerjeve me fajde.
- Përzierja e femrave me meshkuj në manifestime të ndryshme,
- ofrimi i alkoolit në ato ditë festive, si f.v., për fundvitin ndryshe siç njihet *vitin e ri*, dhe gjatë festimit të ditëlindjes të disa muslimanë,
- vallëzimi dhe këndimi në dasma,
- vendosja e unazës së arit kur të fejojhet apo martohet djali, duke i pasuar perëndimorët, apo duke u arsyetuar se një gjë e tillë bëhet në filma kinematografik, po ashtu
- edhe ushqimi dhe përngjashmëria në art dhe dramaturgji me femra të zbuluara dhe çështje tjera të ngjashme të cilat janë në kundërshtim me argumentet e shariatit dhe me rregullat bazë të shariatit.

Nëntema e dytë: Kur llogaritet tradita si traditë dhe llojet e saj

Kjo temë përmban: fuqizimin apo vlerën fuqizuese të traditës dhe atë se a perceptohen tekstet dhe gjykimet e shariatit varësisht prej tregueshmërive të traditës me llojet e tij të ndryshëm dhe ajo çka pason prej llojeve të traditës.

Vlera apo fuqia e traditës tek fukahatë

Fukahatë janë pajtuar në atë se tradita është argument apo burim prej burimeve të shariatit, përderisa Hanefijtë dhe Malikijtë janë zgjeruar më shumë se sa të tjerët në të vepruarit me të dhe janë mbështetur në të në shumicën e ligjeve praktike dhe në perceptimin e teksteve të shariatit duke i përcaktuar të papërcaktuarat dhe duke i sqaruar dispozitat e ndryshme të fikhut si në fushën e adhurimeve po ashtu edhe në dispozitat e raporteve reciproke, në statusin personal, në ligjet penale dhe jopenale, dhe në marrëdhëniet me jashtë, si p.sh:

- përkufizohet qëllimi në fjalët shpifëse varësisht prej formës së paraqitjes apo të shkruarit varësisht siç e kanë traditë njerëzit,

- përcaktohet dënimi në kundërvajtja varësisht se si mund të realizohet qëllimi apo pikësynimi në edukimin e vepërkryerësve, pasi nuk është qëllim final dënimi i tyre.

Shumica e interpretimit të disa shprehjeve të Kur'anit, si p.sh., interpretimi i fjalës “**saidë**” në thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

مَاءٌ فَتَيَمَّمُوا صَعِيدًا طَيِّبًا فَامْسَحُوا بِوُجُوْهِكُمْ وَأَيْدِيكُمْ مِنْهُ

“Dhe lëmoni me dhe të mirë” (El Maide : 6)

Ku sipas mendimit të Hanefijëve: “Është çdo lloj i dheut siç janë: balta, rëra, gipsi, dheu. Pra çdo gjë e cila ngrihet mbi tokë. *E mirë* është e pastra.”

Shafijjtë e përkufizojmë vetëm në *dhe*, ndërsa fjalën *e mirë* e interpretojnë në *dhe pjellorë*.

Ibn Abidijni thotë: Ta dini se në zakon dhe traditë janë bazuar shumë çështje, sa që ato çështje e kanë bërë (traditën) si “bazë”.⁹

1. Argumentet të cilat e bëjnë që tradita të llogaritet si burim.

Dijetarët në argumentimin e traditës janë argumentuar me Kur'an, sunet, ixhmaë dhe kijasë.

Argumentimi me Kur'an: Ekzistojnë ajete të shumta, si p.sh.:

حُذِ الْعَفْوَ وَأْمُرْ بِالْعُرْفِ وَأَعْرِضْ عَنِ الْجَاهِلِينَ ﴿١٩٩﴾

“Ti (Muhamed) merre të lehtë, urdhëro për mirë dhe largohu prej të padijshmëve.” (El Earaf : 199)

Zoti i Lartmadhëruar ka urdhëruar të pasohet **“e mira”**. E vërteta është se në ajetin fënisht është përdorur fjala në aspektin gjuhësor (jo terminologjik). “E mirë” është çështje e cila llogaritet si *e mirë* dhe nuk ka për qëllim traditën si terminologji e fikhut, mirëpo me këtë i ngjanë mbështetësit për ta llogaritur traditën si kuptim terminologjik. Kuptimi etimologjik është më gjithëpërfshirës se kuptimi terminologjik. Argument të kësaj e kemi atë se tradita ndahet në (sipas sqarimit të Shatibiut):¹⁰

- Traditë shariatike;
- Traditë e njerëzve.

E para (tradita shariatike): Ligjvënësi ka pasur qëllimin që ta obligoj ose ta bëjë ligj edukues ose ka kërkuar që të ndalohet rreptësisht ose e ka ligjësuar si *të urryer*.

E dyta: Traditën të cilën ligjvënësi as nuk e ka ndaluar dhe as nuk e ka obliguar me ndonjë argument shariatik.

Zoti i Lartmadhëruar, sa i përket shumës së shpenzimit për gjidhënie ndaj fëmijës për gruan e shkurorëzuar dhe për shpenzimet tjera dhe shumës së kompensimit të përbetimit me ushqim, e ka paraparë aq sa është e njohur dhe aq sa është e zakonshme.

Këtë e vërtetojmë me ajetet si në vijim. Zoti i Lartmadhëruar thotë për gjidhënësen:

وَعَلَى الْمَوْلُودِ لَهُ رِزْقُهُنَّ وَكِسْوَتُهُنَّ بِالْمَعْرُوفِ

“Dhe për prindin e tij, i takon furnizimi për ta dhe veshmbathja për ta, aq sa është e zakonshme.” (El Bekare : 233)

Shpenzimi për bashkëshorten shihet në ajetin:

وَلَهُنَّ مِثْلُ الَّذِي عَلَيْهِنَّ بِالْمَعْرُوفِ

“Dhe për ta, njësoj sikurse për ata, pra aq sa është e zakonshme.” (El Bekare : 228)

Shuma e furnizimit për të shkurorëzuarën:

وَمَتَّعُوهُنَّ عَلَى الْمَوْسِعِ قَدْرُهُ وَعَلَى الْمُقْتَرِ قَدْرُهُ مَتَاعًا بِالْمَعْرُوفِ ۖ حَقًّا
عَلَى الْمُحْسِنِينَ

“...po pajisni ato (me diçka prej pasurisë suaj si dhuratë për to), pasaniku sipas mundësisë së tij dhe i varfri sipas mundësisë së tij. Një pajisje e zakonshme (tradicionale) është obligim për bamirësit.” (El Bekare : 236)

Shuma e shpenzimit për kompensim të përbetimit:

لَا يُؤَاخِذُكُمُ اللَّهُ بِاللَّغْوِ فِي أَيْمَانِكُمْ وَلَكِنْ يُؤَاخِذُكُمْ بِمَا عَقَّدْتُمُ الْأَيْمَانَ ۖ فَكَفَّارَتُهُ إِطْعَامُ عَشْرَةِ مَسَاكِينَ مِنْ أَوْسَطِ مَا تُطْعَمُونَ أَهْلِيكُمْ أَوْ كِسْوَتُهُمْ أَوْ تَحْرِيرُ رَقَبَةٍ ۖ فَمَنْ لَمْ يَجِدْ فَصِيَامُ ثَلَاثَةِ أَيَّامٍ ۚ ذَلِكَ كَفَّارَةُ أَيْمَانِكُمْ إِذَا حَلَفْتُمْ ۚ وَاحْفَظُوا أَيْمَانَكُمْ ۚ كَذَلِكَ يُبَيِّنُ اللَّهُ لَكُمْ آيَاتِهِ لَعَلَّكُمْ تَشْكُرُونَ

“All-llahu nuk ju merr në përgjegjësi për betimet e juaja të paqëllimta (për betim), por ju merr për ato që jeni zotuar qëllimisht. E shpagimi i tij (i betimit të bërë) është duke i ushqyer dhjetë të varfër me ushqim mesatar që ushqeni familjen tuaj, ose duke i veshur ata (të dhjetë), ose duke liruar një rob. E kush nuk ka mundësi t'i bëjë këto, le të agjërojë tri ditë. Ky është shpagim për betimet tuaja kur i thyni ato. Ruani betimet tuaja. Kështu All-llahu ju sqaron dispozitat e veta, ashtu që jeni mirënjohës.” (El Maide : 89)

Sa i përket sunetit, argumentohen me dy hadithe:

E para: Transmetimi merfuë i Ibni Mes'udit: “Atë të cilën muslimanët e shohin të mirë, është e mirë. Atë të cilën muslimanët e shohin të keqe,

ajo tek Allahu është e keqe.”¹¹ Në transmetimin e Ebi Davudit dhe Tabalisijut “kabij”, ndërsa fjala “kabijh” është sinonim i së “keqes”. Kuptimi i hadithit është: atë të cilën muslimanët e llogarisin *të mirë* dhe e bëjnë zakon të mirë, tek Allahu do të jetë *e mirë*. Ky transmetim mund të llogaritet edhe si argumentim i ixhmait sepse tradita mund të jetë edhe si mbështetje për ixhmain.

E dyta: Thënia e pejgamberit s.a.v.s. kur i është drejtuar Hindit, gruas së Sufjanit, pasi që ajo ishte ankuar se burri i saj nuk e furnizon mjaftueshëm: **“Merr nga ai (nga pasuria) aq sa të mjafton ty dhe fëmijëve të tu, dhe sa është e zakonshme.”¹²** Fjala *e zakonshme* e ka qëllimin për shumën e cila zakonisht është e mjaftueshme. Kështu e ka përmendur Shevkani.

Ixhmai: Shatibiu thotë:¹³ Dijetarët janë argumentuar me ixhmain në atë se sheriatu islam është zbritur për t’i realizuar interesat e njerëzve. Nëse kjo është realitet, atëherë duhet pasur parasysh zakonet e tyre, sepse në zakonet e tyre gjendet ajo e cila është interes i tyre. Përderisa bazë e ligjësimi janë realizimi i interesave, atëherë duhet të merret për bazë ajo çka i realizon interesat. Nuk do të kishte kuptim tjetër marrja për bazë e zakonisht përpos kësaj.

Po ashtu Shatibiu është argumentuar me argument tjetër: Mos marrja për bazë e zakoneve shpie deri te ngarkesa në të pamundurën dhe kjo është jo praktike dhe nuk lejohet, sqarimi i kësaj është se: Ngarkesa patjetër duhet të ketë parasysh që të kujdeset për mundësinë e të ngarkuarit dhe diturinë e tij, përndryshe do të ishte ngarkesë në të pamundurën.

Mosllogaritja e zakoneve do të ishte ngarkesë e njerëzve në atë çka nuk kanë mundësi, sepse nuk është lehtë të lihet anash ajo e cila është bërë zakon në shoqëri, kështu që: ngarkesa në atë që i ngarkuari nuk ka mundësi ta zbatojë është ngarkesë për të pamundurën.

Përpos kësaj, për argumentimin e traditës, dijetarët janë argumentuar me ixhmain praktik (të vepruarit e shoqërisë në përgjithësi, pa e mohuar ndokush). Hanefijtë argumentohen me argumente të shumta të ixhmait për traditën, si f.v., mosllogaritja e papastërtisë së madhe nëse është nën perimetrin e dërhemit. Lejimi i shitblerjes së frutave ende pa u pjekur.

Fukahatë janë pajtuar në atë se veprohet me traditën në çështjen për të cilën teksti ka sinjalizuar, ose është përpiluar për të.

Tradita rezulton edhe prej rregullave të cilat janë përpiluar me arsyetim, ose me parimin e interesit, ose rregullave të dëmit dhe dobisë, etj.¹⁴

Argumenti logjik apo i kijasit: Dijetarët janë argumentuar me argumente të shumta për argumentin e traditës, e prej tyre:

Pranimi (miratimi) – Ai i cili i përcjell ligjet dytësore të sheriatit islam e vëren se sheriatit islam ka miratuar disa ligje zakonore të cilat kanë qenë të pranishme para islamit, si f.v., shitblerja me paradhënie, shitblerja e quajtur “urajë”,¹⁵ sistemi i organizimit aksionar, dhe çdo gjë e cila ka qenë e mirë (zakon i mirë) ka mbetur në islam dhe çka nuk ka qenë e dobishme është eliminuar, si f.v., aktet mashtruese dhe kamata.

Shembull tjetër. Po të mos ishin rregullat e traditave nuk do të kuptohej feja nga baza e saj, duke pasur parasysh njohjen e ligjeve dytësore, andaj duhet të merret parasysh në ligjësim, sepse siç e përmend Shatibiju: Feja kuptohet vetëm nëpërmjet pejgamberëve, pejgamberia kuptohet vetëm nëpërmjet mrekullive, përderisa nuk do të kishte kuptim mrekullia po të mos ishte e jashtëzakonshme, pra jashtë rregullave zakonore, kështu pra, po mos të ishte e zakonshmja nuk do të kuptohej e pazakonta.¹⁶

Shembull tjetër: Është e patjetërsueshme që burimet e zakoneve të merren për bazë sepse ngarkesa ka vlerë kur merret për bazë e zakonshmja, për këtë kemi argumentin se zakoni është i gjeneruar nga ajo se ndëshkimi është si rrjedhojë e të kundërtës, për këtë arsye janë ligjësuar ndëshkimet e hakmarrjes dhe ligjeve tjera penale.¹⁷ Zakoni na tregon se fara është shkak i mbirjes së farave, martesë është shkak i lindjes së trashëgimtarëve, tregtia është shkak i shtimit të pasurisë, e tjera e tjera zakone. Për këtë arsye janë ligjësuar ligjet e posaçme për aktet e frutave dhe perimeve, ujitjes së arave, gjallërimin e tokës jopjellore. Ligjet e shitblerjes, martesës, e të ngjashme. Të gjitha këto tregojnë për të shkaktuarën nga shkak.

Përfundim: Kemal bin Hemami ka thënë: Atëherë kur nuk ekziston teksti, ligjërisht tradita zë vendin e ixhmait.¹⁸

2. A ndikon tradita e shprehjeve në ligjet e sheriatit.

Tradita e shprehjeve ndikon qartë në kuptimin e ligjeve të sheriatit. Çdo folës, fjalën e tij e shpreh në gjuhën dhe zakonin e tij dhe e precizon qëllimin nga tekstet e sheriatit nëpërmjet kuptimit të cilin kuptim e ka për qëllim zakonisht. Kjo do të thotë, shprehjen të cilën njerëzit e përdorin për qëllimin e caktuar varësisht prej qëllimit të tij me atë fjalë e cila ka edhe kuptim tjetër edhe nëse ajo fjalë është në kundërshtim me kuptimin e drejtë të saj e cila është vendosur të jetë gjuhësisht, ngase tradita e ka bartë të ketë kuptim tjetër, kështu që tradita asaj fjale i ka dhënë kuptim tjetër të drejtë, ndërsa e ka larguar nga kuptimi sintaksorë i saj. Për këtë arsye fukahatë Hanefijë kanë thënë: Tradita është përcaktues ndaj gjuhës,¹⁹ kështu që fuqizohet shitblerja e foljes në kohën e kaluar, shembull, e shita, e bleva. Për këtë janë pajtuar fukahatë. Malikijtë deklarojnë se, shitblerja fuqizohet me atë që tregon pajtueshmëri, qoftë me dhënie-marrje.

Në “Mexhele” figuron: **“Fjala e drejtë nuk merret parasysht kur zakoni tregon për kuptim tjetër.”** (m, 40). Në “Risalen” e tij, Ibn Abidijni thotë:²⁰ “Fjalës së përбетuesit, betuesit, testamentlënësit, vakëflënësit dhe çdo kontraktuesi i jepet kuptimi i gjuhës së zakonit të tij edhe nëse është në kundërshtim me gjuhën arabe dhe terminologjinë e sheriatit.”

Në lidhje me këtë kemi raste të shumta. Përбетimet dhe betimet bazohen në zakon, po ashtu edhe fjalët për martesë dhe shkurorëzim. Ndonjëherë me fjalën shkurorëzim folësi ka për qëllim vetëm kërcënim për shkurorëzim dhe jo për shkurorëzim, shembull, “Do të të shkurorëzoj ose do të jesh e ndaluar për mua.”

Fjalët e vakfit bazohen në zakon si, f.v., përcaktimin e mbikëqyrësit për vakf, që do të thotë se e autorizon administratorin e vakfit për ndërtim dhe mirëmbajtje, varësisht siç e kanë pasur zakon vakëflënësit e mëhershëm. Rast tjetër, kur thuhet: Mua më takon farzi sheriatik. Qëllimi është që mashkullit t’i jepet dy hise, ndërsa femrës një hise trashëgimore.

Shitblerja me çmim simbolik llogaritet dhuratë, po ashtu “Dhurata me kompensim të caktuar” llogaritet shitblerje. Në vendet e Sirisë për shitblerjen e fryteve në trung thuhet “tedmijn”. Ndonjëherë për të garantuar se produkti nuk ka kurrfarë të mete, njerëzit (tregtarët), shembull, për shitblerjen e automjeteve e përdorin shprehjen **“i tëri është hallall”**, e atëherë e merr atë konotacion. Pjesët e bashkëngjitura të sendit bëjnë pjesë

në shitblerje, si f.v., mjetet rregulluese të automjetit, çesmja dhe pjesët tjera të nxjerrjes së ujit për në banjë.

Testamenti me pemët frutore në plantacion, bën që e lënura vakëf të ketë frytet në trungje, e jo që ato të jenë inekzistente.

Merren parasysh metodat e publikut si në akte, interpretime, në rezyme, në lejime, në qiradhënie edhe nëse ato janë në kundërshtim me dialektet gjuhësore.

Nga kjo vërehet qartë se shprehjet e zakonshme përcaktojnë qëllimin e thënies së folësit dhe udhëzon në atë çka përmban fjala dhe çka rezulton në të drejta dhe në obligime. Karafiju thotë: “Është e vërtetë se i jepet përparësi shprehjeve të zakonit ndaj atyre gjuhësore. Kjo është çështje obligative, sepse sipas ixhmait shfuqizuesi ka përparësi nga e shfuqizuara e kështu është edhe në këtë rast.”²¹

3. A merret parasysh tradita vepruese në ligjet e sheriatit?

Tradita vepruese konsiderohet se ka ndikim në ligjet e veprimeve të rëndomta dhe në raportet qytetare të ndryshme të cilat kanë të bëjnë me të drejtat e njerëzve ose që kanë të bëjnë me statusin personal ose në gjykime ose në dëshmi ose në dëme, etj.

Ndikimi shihet në përcaktimin e gjykimit dhe në kategorizimin e rezultateve të kontratave dhe në sqarimin e detyrave dhe obligimeve të cilat ndërlidhen dhe të cilat janë në përputhshmëri me zakonet, nëse ai zakon nuk është në kundërshtim me tekstet e sheriatit në Kur'an dhe sunet.

Peshore bëhet tradita. Për këtë arsye Hanefijtë dhe të tjerët, si dhe Maliku kanë thënë: **“Tradita është gjykuese.”** (m/36 : Mexhele). **“Përcaktimi me traditë është i njëjtë sikurse përcaktimi me tekst.”** (m/45). Autori Bejriju, komentues i librit “El-Eshbau ven-Nedhair” të ibni Nexhimit ka thënë: **“Vendimmarrja me traditën është sikurse vendimmarrja me argument të sheriatit.”**²² **“E njohura prej traditës është sikurse e kushtëzuara me kusht.”**

Në veprime të zakonshme kemi shumë raste praktike,²³ e prej tyre: Përbetuesi i cili përbetohet se nuk do të hajë mish, përkufizohet në mishin e zakonshëm të atij qyteti, si f.v., mishi i lopës dhe deles dhe këtu nuk bën pjesë mishi i peshkut. Përbetuesi i cili përbetohet se nuk do të hipë në mjet transportues përfshinë çdo mjet transportues të zakonshëm në të gjitha kohët

dhe merret në konsideratë edhe hipja mbi kafshë ose automjet, varësisht prej traditës e cila mbizotëron.

Furnizimi për bashkëshorten përcaktohet varësisht prej gjendjes sociale të bashkëshortëve, pra të varfër apo të pasur, dhe varësisht prej gjendjes sociale të shoqërisë.

Në ligjet e raporteve fqinjësore, përcaktohet tejkalimi i veprimit i cili shpie në dëmtimin e të tjerëve varësisht prej asaj që është e zakonshme apo tradicionale. Kush e ndez zjarrin në parcelën e tij dhe tymi e flaka ngjiten lartë dhe i djeg bimët dhe pemët e fqinjit, ai dënohet nëse e tejkalon atë që është e zakonshme, e kjo edhe kur e ka ndez zjarrin kur ka erë të madhe.

Në kontratat e sigurimeve, si në huadhënie dhe në shfrytëzim. Huamarrësi i sendit dhe marrësi i sendit në garancion dënohet kur sendin e marrë hua e lë tek ai i cili në kushte të zakonshme nuk e ruan dhe prishet, si f.v., t'i lihet shërbëtorit ta ruaj diamantin. Nëse ai i cili e merr një send hua dhe e shfrytëzon në atë çka nuk është e zakonshme dhe prishet, atëherë ai huamarrës dënohet.

Nga kjo kuptohet se tradita e veprimeve të zakonshme në ushqim, veshmbathje, shfrytëzim të mjeteve transportuese, në ruajtje dhe në shfrytëzim të sendeve i përkufizon kontratat dhe i përcakton detyrimet dhe dënimet.

Shembuj praktik të kësaj në kodin civil. Shembull, lejimi i marrjes së pemëve të cilat kanë rënë në tokë pa lejen e pronarit të tyre. Pranohet heshtja e vajzës virgjëreshë kur kujdestari i saj kërkon pëlqimin e saj. Në të njëjtën kohë llogaritet edhe pranim por edhe autorizim, për shkak të turpfit dhe moralit të saj. Fuqizimi i shitblerjeve me dhënie-marrje. Kjo për shkak të zakonit të përgjithshëm, i cili në marrjen e artikullit e llogaritet se e di çmimin dhe për shkak të besueshmërisë së fuqishme në mes të blerësve dhe shitësve në kushtin e pëlqimit dhe pranimit. Detyrimet në kontrata e kompensime i përkufizon zakoni. Thuhet: Shitësi dëmshpërblen ndërmjetësuesin, taksat i paguan klienti. Po ashtu zakoni e përkufizon përgjegjësinë e transportimit të artikullit deri te shtëpia e blerësit, kjo vlen për disa artikuj.

Pjesët shtesë të artikullit i përcakton zakoni. Në blerjen e shtëpisë bën pjesë çelësi i shtëpisë. Në blerjen e automjetit, bëjnë pjesë, pjesët ndihmëse rezervë, si dhe pjesët riparuese të domosdoshme.

Pagesa e qerasë bëhet sipas zakonit, nëse nuk paraqitet në kushte të qerasë, pra pagesa të menjëhershme ose të afatizuara (të mëvonshme).

Nëse babai e përgatit vajzën e tij në rastin e martesës së saj prej pasurisë së tij, atëherë ajo pasuri është pronësi e saj.

Në dokumentacione, në zarfe, duhet të shkruhet, varësisht siç e parasheh zakoni.

Nga kjo vërehet se sa ndikon tradita praktike në sqarimin e detyrimeve, parandalimin e mosmarrëveshjeve dhe ngatërresave në ato çështje. Ajo ndikon varësisht prej ndryshimit të zakoneve dhe traditave dhe ndryshimit të mënyrës së jetesës dhe zhvillimit të shkencës dhe civilizimit.

Tradita përkujdeset për secilën kategori, si të punëtorëve, tregtarëve, prodhuesve, bujqve, etj.

Tradita e veprimit të përgjithshëm shoqëror bëhet krahasues i tekstit dhe specifikues i tekstit të Hanefijtë, dhe kjo nuk do të thotë anashkalim i tekstit, por teksti vazhdon të jetë aktiv në çështjet tjera të cilat janë brenda tekstit të përgjithshëm. Kështu që ekziston aktivizimi edhe i traditës edhe i tekstit së bashku.

4. A duhet të llogaritet tradita si traditë e veçantë dhe e përgjithshme së bashku apo vetëm traditë e përgjithshme?

Nuk ka dallim në mes të traditës së përgjithshme dhe të veçantë, nëse në secilën prej tyre ka rregull ose që vazhdohet të veprohet me ta ose që veprohet me to në shumicën e rasteve, përpos në të përgjithshmet dhe shumicën e rasteve, përpos në të përgjithshmet dhe në të veçantat. E përgjithshmja përfshinë të gjitha qytetet dhe shoqëritë. E veçanta përfshinë vetëm një kategori të shoqërisë, si f.v., vetëm tregtarët, vetëm prodhuesit, vetëm bujqit. Secila kategori vepron në bazë të detyrimeve (të asaj kategorie) ose që e kanë traditë një pjesë e caktuar e qytetit dhe jo të tjerët.

Kështu, në disa raste tradita e posaçme llogaritet sikurse tradita e përgjithshme. Mirëpo, fuqia e traditës së posaçme është më e dobët se fuqia e traditës së përgjithshme. Për këtë arsye Hanefijtë²⁴ e kanë definuar që tradita e përgjithshme lihet kur përballë ka kijasin, por lejohet që të jetë specifikues i argumentit sheriatik, shembull, aktet e porositjes së prodhimit, qiradhënies, paradhëniet, dhëniet, përdorimi i banjave pa u caktuar sasia e ujit dhe koha e qëndrimit në të, dhe pirja e ujit prej njerëzve pa përcaktuar masën, për shkak të dallimit të njerëzve në pije dhe për shkak të njerëzve të cilët janë më shumë të etur apo më pak të etur, etj.

Sa i përket traditës së veçantë, merret parasysh nëse bie ndesh me tekstin e fikhut të transmetuar nga ndonjë drejtim, mirëpo ka dallim nga tradita e përgjithshme sepse vlen posaçërisht për pjesëtarët e asaj tradite.

Përderisa, **sa i përket traditës së përgjithshme**, ligji vlen për të gjithë pjesëtarët e qyteteve. Tradita e posaçme nuk vlen nëse është në kundërshtim me tekstin e sheriatit dhe kijasi nuk anashkalohet prej tij dhe nuk i specifikon hadithet (gjurmuese) në përjashtim të traditës së përgjithshme²⁵ siç e kemi shpjeguar më herët.

Në librin “Dhahiru rivajeti”, sa i përket prioritetit të traditës ndaj tekstit, Ibni Abidijni ka thënë: Nuk ka dallim në mes të traditës së përgjithshme dhe të veçantë përpos asaj se tradita e përgjithshme miratohet me ligje të përgjithshme ndërsa tradita e veçantë miratohet me ligj të veçantë.

Përfundim i kësaj është se: Dispozita e traditës miratohet edhe për të përgjithshmit edhe të veçantët:

- **Tradita e përgjithshme** e të gjitha qyteteve miraton ligjin për të gjitha qytetet.

- **Tradita e veçantë** e një qyteti miraton ligjin vetëm për atë qytet.²⁶

5. Si e llogarit shumica absolute e dijetarëve traditën e veçantë?

Shumica absolute e dijetarëve nuk e marrin parasysh traditën e posaçme, saqë nuk e llogarisin as në tekstet e fukahave.

Pa dyshim se tradita e posaçme nuk është në nivelin e dispozitës së përgjithshme, por e përgjithshmja fuqizon dispozitën e posaçme si f.v. shprehjet të cilat janë të njohura në raportet ndërnjerëzore të cilat dallojnë prej një vendi në vendin tjetër.

Shumica absolute e dijetarëve, e në ta bëjnë pjesë edhe Hanefijtë, të cilët e kushtëzojnë që për të qenë tradita e vlefshme duhet që i tërë qyteti të jetë islamik dhe te ta nuk merret parasysh tradita e veçantë, përpos nëse atë e konfirmon suneti, e atëherë llogaritet si argument.

Përderisa shejhët, Buhariu, Belehi, Havarizmi, Ebu Lejthi dhe Ebu Ali el-Nesefiu, kanë thënë: **“Tradita e veçantë llogaritet edhe si argument edhe si specifikues.”** Për këtë arsye kanë dhënë fetva në lejin e shumë çështjeve të veprimtarive reciproke të cilat janë të ndaluara me argumente.

Shumica absolute e dijetarëve të cilët nuk e marrin për bazë traditën e veçantë kanë dallime mes vete vetëm në atë traditë e cila është bërë argument i ligjit të qartë, për të cilën kanë thënë: **“Tradita e veçantë e specifikon dhe e përcakton argumentin.”**, që do të thotë, ka të bëjë me traditën e cila definon argumentet dhe tekstet e sheriatit, pra është tradita e cila është argument i ligjit të qartë dhe në qoftë se gjendet tekst i cili është në kundërshtim me traditën e veçantë nuk lejohet që të jetë shfuqizues i tekstit dhe as përcaktues i tij, kështu pra, tradita e përgjithshme me traditën e veçantë janë të barabartë.

Argument i kësaj është se, tradita e veçantë është marrë për bazë në raste të shumta, si f.v., në çështjet e përbetimeve, kontratave, betimeve dhe vakëfeve dhe fjala e tyre shikohet në bazë të traditës së tyre.

Kështu e ka përshkruar Kemal bin Hemami dhe Ibn Nexhijmi në librin “El-Eshbah”.²⁷

Kjo vërtetohet me atë se merret për bazë ndryshimi i kushteve dhe faktorëve në dënimet e papërcaktuara dhe në atë çka i lejohet dhe sa shpenzohet në furnizimin e gruas (së shkurorëzuar). Në këto raste merren parasysh vendet dhe kohërat në të cilat jetojnë. Kjo është tradita në të cilën bazohen zbatimet e ligjeve.

Ibn Abidijni thotë se:²⁸ Dispozitën e përgjithshme nuk e vendos tradita e veçantë. Kjo tregon se nuk merret parasysh dhe nëse gjendet tekst në kundërshtim të traditës së veçantë nuk lejohet ta shfuqizoj tekstin dhe as ta përcaktoj atë (nëse është e papërcaktuar).

Nëntema e tretë: Kushtet e pranimi të zakonit dhe të traditës dhe rrugës së prioritetit të tyre kur janë në kundërshtim me tekstet e sheriatit

Kjo temë përmban pesë çështje.

1. Cilat janë kushtet për t'u marrë për bazë tradita?

Për t'u bërë tradita bazë e ligjeve të sheriatit ose argument i sheriatit duhet t'i plotësoj kriteret apo katër kushtet të cilat i kanë caktuar dijetarët e usulit, e ato janë:²⁹

Kushti i parë: Tradita duhet të jetë e rregullt dhe praktike në të shumtën e rasteve.

Çështja “të jetë e rregullt” është që të praktikohet në të gjitha rastet ose në të shumtën e rasteve. Nëse nuk veprohet rregullisht, ajo nuk është e rregullt, ose nëse nuk veprohet në të shumtën e rasteve, atëherë ajo traditë nuk merret parasysh.

Ky kusht kërkohet në të gjitha llojet e traditës, në traditën shprehimore, praktike, të përgjithshme dhe të veçantë.

E rregullta apo e shumta, nuk e ka qëllimin e përgjithësisë sepse përgjithësia e traditës nuk është e rregullt sepse me traditën e përgjithshme kemi për qëllim shpërndarjen e saj në të gjitha vendet, përderisa tradita e veçantë është ajo që bëhet zakon në një qytet apo qytete të caktuara ose në mes të një profesioni apo zanati dhe jo në profesionet apo zanatet tjera, përderisa e rregullta apo veprimi në të shumtën e rasteve nuk kërkohet që të jetë traditë e përgjithshme, por qëllimi është që të veprohet tek të gjithë apo te shumica e tyre, që do të thotë të mos ketë kundërshtime në mes tyre.

Nga kjo rezulton se është e rregullt klasifikimi i meherit në mehr të menjëhershëm dhe mehr të afatizuar, nëse këtë e praktikojnë banorët e një vendi në të gjitha rastet e martesës.

Nëse artikujt shitblehen me dërm, atëherë ajo valutë quhet valutë e atij vendi. Shumica është fakti i pëlqimit të tyre. Fakti se ata kanë nevojë që ta marrin për bazë quhet *traditë e tyre*.

Kushti i dytë: Tradita duhet të jetë aktive në kohën kur dëshirohet të gjykohet për atë veprim.

Me këtë kusht nënkuptohet që tradita të jetë ekzistuese në momentin e veprimit të atij veprimi, e që qëllimi është që tradita t'i paraprijë veprimit dhe kjo nuk merret për bazë nëse është vepruar në të kaluarën (para traditës). Nëse tradita ndryshohet, nuk merret për bazë veprimi me traditën paraprake (të vjetër), por me traditën e re.

Kjo po ashtu përmban edhe llojet e traditës shprehimore dhe traditën vepruese.

Në traditën shprehimore: Fjala e folësit llogaritet vetëm si fjalë e tij (jo e traditës), si në vakëf, përbetim, betim, testament, shkurorëzim. Po ashtu edhe fjala e kontraktuesit me kontraktuesin në kuptim të traditës e jo në kuptimin etimologjik apo të gjuhës, nëse ndryshon tradita e të kuptuarit të atyre shprehjeve tradicionalisht. Nëse në mendjen e njerëzve ndryshon tradita, atëherë nuk merret për bazë tradita e mëvonshme në interpretimin e fjalëve. Kështu që shprehja (obligative e shariatit) e cila do të rezultonte për mashkullin dy hise e femrës një hise për vakëflënësin dhe testamentlënësin. Nëse kjo traditë ndryshon dhe krijohen koncepti i të barazuarit të hiseve në mes të mashkullit dhe femrës nuk ndryshohet vendimi i mëhershëm i vakëflënësit ose i ndonjërit prej testamentlënësve.

Kështu është edhe me tekstet e shariatit, të cilat kuptohen varësisht prej tregueshmërisë së tyre në kohën e ardhjes së tekstit, si f.v., “në rrugë të Allahut” dhe fjala “dhe udhëtarit” për meritoret e zekatit. E para ka për qëllim “për interes të xhihadit”, e dyta “personit të cilit i janë harxhuar shpenzimet e rrugës”. Nëse tradita ndryshon dhe p.sh. për shprehjen e parë i jepet kuptimi *për studentin*, ndërsa për shprehjen e dytë *fëmijën e abortuar (të mbetur në rrugë)*, mbetet koncepti për tekstin shariatik i shprehjes së traditës së parë për të cilin ka ardhur.

Tradita praktike llogaritet aktive në momentin e veprimit (të mëhershëm) e jo të riut. Shembull: ajo çka llogaritet e metë në artikullin e blerë dhe në atë çka bën pjesë në atë artikull dhe pagesa e qerasë me këste për inventarë dhe nuk zbatohet tradita e re dhe të anashkalohet e vjetra. Sujutiu thotë:³⁰ Tradita e cila llogaritet për shprehje është tradita e shprehjeve të vjetra (të kaluara) dhe jo të rejave.

Nëse tradita është që banesën ta mobiloj bashkëshortja, pastaj ndryshon tradita dhe bëhet traditë që ta mobiloj bashkëshorti, atëherë merret për bazë ajo traditë e cila ka qenë në momentin e aktit të kurorëzimit.

Kushti i tretë: Tradita duhet të mos jetë në kundërshtim me atë që thuhet qartazi.

Kjo nënkupton se veprohet me traditën përderisa nuk ekziston deklaratë në mes të kontraktuesve në kundërshtim me të, por nëse kontraktuesit deklarojnë në kundërshtim me atë që është tradicionale, atëherë veprohet në bazë të deklaramit dhe marrëveshjes së tyre (jo të traditës), pra nuk merret për bazë tradita sepse rregull e fikhut është: **Nuk merret parasysh tregueshmëria, kur veç ekziston deklarimi (i qartë).**

Ky kusht është bazë e përcaktimit të rregullit **“E njohura me traditë si e kushtëzuara me kusht.”**.

Në bazë të këtij kushti rezulton se, huazimi në një kohë dhe në një vend dhe masë bëhet ashtu siç e përcakton e huazuara edhe nëse vjen ndonjë përcaktim i mëvonshëm i cili është në kundërshtim me përcaktimin e zakonshëm. Nëse sendi i huazuar nuk ka qenë i përcaktuar, por ka qenë i papërcaktuar, atëherë e huazuara përcaktohet në bazë të asaj siç e përcakton tradita.

Nëse kontraktuesit në martesë pajtohen për afatizimin e të gjithë mehrit, nuk zbatohet tradita e cila bëhet që të afatizohet një pjesë e mehrit. Nëse nuk janë pajtuar në afatizimin e mehrit, veprohet në bazë të traditës.

Kushti i katërt: Tradita duhet të mos jetë në kundërshtim me tekstin shariatik apo me ndonjë bazë themelore dhe të prerë të shariatit.

Kjo do të thotë: Tradita nuk duhet të bie në kundërshtim me tekste të shariatit në Kur'an apo sunet, apo të kundërshtojë ndonjë parim të ligjësimi të prerë, si f.v., *pëlqimi në kontrata*. Nëse ndodh kundërshtimi, tradita konsiderohet e pavlefshme sepse tekstet e shariatit dhe parimet e tij i paraprijnë traditës.

Nëse njerëzit e bëjnë traditë që në manifestime shoqërore dhe individuale të shërbejnë alkool dhe lojëra të bixhozit, të vishen me rroba të plazhit, e çështje tjera zakonore të prishura, si f.v., barazimi në mes të meshkujve dhe femrave në disa vende islame. Këto zakone jo të shëndosha nuk merren parasysh.

Mirëpo, përjashtohet teksti i traditës i cili është: Teksti sheriatik i cili buron nga Ligjvënësi bazuar nga tradita e cila bëhet si traditë e bazuar dhe e arsyetuar, shembull, krahasimi i artikujve të kamatizimit. Nëse arsyeja e këtyre artikujve (gruri, elbi, hurma dhe kripa) është masa, mirëpo pastaj ndryshojnë njësitë matëse dhe bëhet që këto artikuj peshohen pasi që janë peshuar më herët, atëherë duhet që të ndryshojnë njësitë matëse varësisht prej ndryshimit të traditës. Kështu, paralelizmi ligjësist bëhet me njësi matëse, atëherë tradita nuk është në kundërshtim me tekstin sheriatik. Ky është mendimi i Ebu Jusufit (Zoti e pastë mëshiruar) dhe është argumentimi më i fuqishëm dhe më i përafërt me shpirtin e ligjësimit sheriatik.

1. Cila është dispozita kur tradita bie ndesh me tekstin e përgjithshëm ashtu që bëhet e patjetërsueshme që të veprohet me atë traditë duke e specifikuar atë tekst?

- ose kur bie ndesh teksti i përgjithshëm me traditën momentale.
- ose kur bie ndesh teksti i përgjithshëm me traditën e cila vjen në vijim.³¹

E para:

- a. Ndodh të bie ndesh teksti i përgjithshëm me traditën shprehimore;
- b. Ndodh të bie ndesh teksti i përgjithshëm me traditën vepruese.

a. **Kur bie ndesh tradita shprehimore me tekstin e përgjithshëm.** Të kuptuarit e tekstit brenda kornizës së konceptit tradicional. Për këtë usulistët janë të pajtimit që, tradita shprehimore merr kuptimin mbi tekstin e përgjithshëm sepse tradita shprehimore e bën që të njihet ajo shprehje si shprehje në kuptim të drejtë tradicionale. Ajo shprehje tradicionale ka përparësi ndaj po asaj shprehje në kuptim të drejtë gjuhësor. Në bazë të kësaj kuptohen fjalët si fjala namaz, agjërime, haxh, etj., si dhe fjalët në marrëdhëniet reciproke si, shitblerja, qiraja, statusi personal, siç janë, martesë, shkurorëzim, ideti, varësisht prej kuptimit tradicional.

b. **Nëse bie ndesh tradita praktike me tekstin e përgjithshëm.** Hanefijtë shkojnë në atë drejtim që tradita e specifikon tekstin dhe e përcakton të papërcaktuarën, mirëpo në këtë shumica absolute e dijetarëve i kanë kundërshtuar, sepse tradita praktike sipas konceptit të Hanefijëve tregon nevojën për atë që e kanë bërë traditë dhe nëse mënjanohej ajo çka njerëzit e kanë bërë traditë, u shkaktohet dëm dhe vështirësi atyre. Të

vepruarit me këtë përparësi, si f.v., kontrata me paradhënie përmban tekstin pejgamberik i cili ndalon që njeriu të shes atë që nuk e ka prezent, mirëpo të gjithë njerëzit e kanë bërë traditë që të veprojnë në atë mënyrë dhe atë në të gjitha vendet për shkak të nevojave të tyre. Kështu, kjo traditë e ka specifikuar tekstin.

Kur Ligjvënësi e ndalon kamatën në ushqim, Ai e ka përkufizuar ndalesën në ushqim sepse ushqimi është më i përdorshmi, dhe te Hanefijtë është gruri, ndërsa shumica absolute e dijetarëve e kanë paraparë ushqimin në përgjithësi duke vepruar me rregullin e përgjithshëm, vetëm se dijetarët Malikijë³² në këtë çështje i përkrahin Hanefijtë. Ata kanë marrë vendim se tradita praktike momentale e specifikon tekstin e përgjithshëm dhe e përcakton të papërcaktuarën, andaj argumentohen se gruaja fisnike nuk e ka për detyrë gjidhënien e fëmijës së saj nëse fëmija e pranon qumështin e gjirit nga ndonjë grua tjetër, duke vepruar me traditën e cila ka ekzistuar në kohën e zbritjes së ajetit: **“Dhe nënat e tyre u japin gjë fëmijëve të tyre dy vite të plota.”**

E dyta: Kundërshtimi i traditës së re me tekstin e përgjithshëm.

Janë dakorduar usulistët që, nëse bie ndesh teksti me traditën e mëvonshme, nuk lejohet që tradita ta specifikon tekstin sheriatik edhe nëse është traditë e përgjithshme qoftë shprehimore qoftë vepruese sepse po ta specifikonte, llogaritet se e shfuqizon tekstin, e teksti nuk shfuqizohet me traditën e mëvonshme sepse kjo do të shpinte në demolimin dhe eliminimin e ligjit.

Nga kjo rezulton që, tekstet e Kur'anit dhe të sunetit interpretohen varësisht prej traditës e cila ka ekzistuar kur kanë zbritur ajetet dhe janë thënë hadithet dhe nuk shikohet në ndryshimin e traditave si p.sh., terminologjitë e mëvonshme të fukahave në ndarjen e dispozitave të sheriatit në: farz, vaxhib, mendub, mekruh, e ndaluar. Nuk lejohet interpretimi i urdhëresave dhe ndalesave me ta. Tekstet e fukahave, vakëflënësve, testamentlënësve, mosha e bulugut, donatorëve, të martuarve. Deklarimet e të afërmve të Zotit në shkencën e akides dhe kushtet e tyre, nuk lejohet interpretimi ose specifikimi i qëllimit të themeluesve varësisht prej traditës së mëvonshme por interpretohen çështjet varësisht prej traditës së kohës së tyre (jo të traditës së mëvonshme) si f.v., ustaz, qëllimi i kësaj fjale ka qenë për pronarin e prodhimtarisë (fabrikës), pastaj është përdorur për profesorin e lëmime shkencore.

Teksti i fikhut të hershëm nuk interpretohet në kuptimin bashkëkohor të tanishëm.

E treta: Kundërshtimi i traditës me tekstin e veçantë (specifik).

Nëse Ligjvënësi dëshiron të rregulloj diçka me një tekst specifik, duke pasur për qëllim sqarimin e prishjes ose dëmit prej asaj çështjeje dhe e ndalon atë. Ajo dispozitë kategorikisht është fuqizuese dhe ndalohet që të paralizohet teksti sheriatik dhe praktikimi i tij sepse sheriatu është obligim dhe nuk lejohet që të paralizohet duke vepruar me të kundërtën e saj. Në të kundërtën ligjësimi do të ishte i pakuptimtë.³³

Ibn Nexhijmi ka deklaruar: Merret për bazë ligjësimi i traditës në përgjithësi dhe jo në veçanti³⁴. Shembull: Anulimi dhe ndalimi i adaptimit të fëmijëve, gjë e cila ka qenë traditë në kohën e injorancës, e kjo me ajetin fisnik:

“Ju thirrni (mbështetni) ata në etërit e vërtetë të tyre, kjo është më e drejtë te All-llahu, e nëse nuk ua dini (nuk dini se kush janë) etërit e tyre, atëherë ata janë vëllezërit tuaj dhe të afërmit tuaj në fe. Nuk është ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar, por (është mëkat) ajo që zemrat tuaj e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues.” (El Ahzab : 5)

Nuk lejohet të rikthehet me traditë të re dhe nuk lejohet në asnjë mënyrë të rikthehet qoftë edhe nëse bëhet traditë e përgjithshme. Shembull: ndalimi i shitblerjeve mashtruese siç janë: shitblerja MUNABEDHE, shitblerja MULAMESE, shitblerja HUSATE, shitblerja MULAKIJH VEL MEDAMIJN, shitblerja DARBETIL KANIS, të cilat kanë qenë në kohën e injorancës. Pejgamberi s.a.v.s. i ka ndaluar këto lloje të shitblerjeve.

Pasi që Pejgamberi s.a.v.s. i ka ndaluar këto lloje të shitblerjeve, nuk lejohet që nëpërmjet ndonjë tradite të rikthehen dhe të lejohen. Shembull: Të vidhet sendi i borxhmarrësit, i cili ka qenë i lejuar në kohën e injorancës dhe tek romakët, mirëpo islami këtë e ka ndaluar dhe e ka bërë obligim t'i jepet afat shtesë të vështirësuarit dhe të ngarkuarit me borxh. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

وَإِنْ كَانَ ذُو عُسْرَةٍ فَنَظِرَةٌ إِلَىٰ مَيْسَرَةٍ

“Dhe nëse është në gjendje të rëndë, le të pritët deri sa të jetë i liruar.” (El Bekare : 280)

Nuk lejohet që të veprohet me ndonjë traditë të re në kundërshtim me tekstin. Shembull: Kurorëzimi “SHIGAR” (*lloj martesë ku njëra palë kërkon nga pala tjetër që të këmbëhen vajzat në këmbim të mehrit të njëra-tjetrës dhe të bëhet martesë me ndërrime*) të cilin lloj kurorëzimi e ka ndaluar pejgamberi s.a.v.s. dhe islami e ka zhvleftësuar. Nuk lejohet që të veprohet me traditë të re e cila është prezent në disa vende sot.

2. Çfarë ndikimi kanë traditat në tekstet e sheriatit?

Traditat të cilat ndryshojnë nuk mund të kenë ndikim në tekstet e sheriatit ashtu që të jenë vendime absolute të ngjarjeve dhe të jenë sqarues i ligjeve themelore me të cilat ka ardhur islami me tekste urdhëruese dhe ndaluese, si p.sh., ndalimi i ndalesave, pëlqimi në kontrata, zbatimi i kontratave, dëmshpërblimi i cili u shkactohej të tjerëve, patjetërsueshmëria e ndalimit të lëndimeve dhe parandalimin e krimit, sigurimi i të drejtave. ligjësimi i vetpranimit e jo për të tjerët (vetpranimi është argument i mangët), përgjegjësia personale apo individuale për t’u shpërblyer veç e veç, apo për t’u dënuar veç e veç dhe mosndëshkimi për shkak të paraardhësve apo të familjarëve, etj., e raste tjera të ngjashme për të cilat sheriatu islam është themeluar për zhvillimin e individit dhe të shoqërisë.

Kjo është kështu, përpos nëse ekziston ndonjë tekst, arsyetohet me ndonjë arsyetim e pastaj ndryshon arsyetimi apo shkak, si f.v., pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar përcaktimin arbitrar të çmimeve me thënien: **“Vërtet Allahu është ngushtues i gjendjeve dhe zgjerues i tyre. Ai është përcaktuesi i furnizimit.”**³⁵ sepse metoda e mospërcaktimit arbitrar të çmimeve ka qenë i papërshtatshëm sepse tregtarët i rrisnin çmimet dhe e tepronin, pastaj ka ndryshuar tradita dhe në favor të kësaj kanë dhënë fetva shtatë dijetarët e Medinës së bashku me imam Malikun dhe dijetarët e mëvonshëm Zejdij, përpos ushqimeve njerëzore dhe të kafshëve, pra përpos këtyre artikujve, në artikujt tjerë e kanë lejuar përcaktimin e çmimit, sepse shtrenjtimi i çmimeve ka qenë për shkak të appetiteve të vet tregtarëve, përderisa në kohën e pejgamberit s.a.v.s. shtrenjtimi ka qenë për shkak të ofertës së vogël dhe kërkesës së madhe, e atëherë lejohet përcaktimi i çmimit arbitrarë me traditë të re.

Përndryshe, teksti i traditës siç e cekëm më lartë ka qenë traditë e këmbimit mall me mall në sasi në mallrat kamatare, pastaj ka ndryshuar dhe ka filluar metoda e këmbimit të mallrave me peshë.

Përndryshe ligjet të cilat kanë rregulluar arkën qendrore islame, si p.sh., mosdhënia e zekatit familjes së hashimitëve, pastaj Hanefijët dhe Malikijët e kanë lejuar t'u jepet atyre.

Sa i përket dispozitave tjera me ixhtihadë të cilat krahasohen dhe shihet interesi, pra të cilat janë të bazuara me kijasë ose nga parimi i interesit ato u nënshtrohen ligjit të ndryshimit, për këtë arsye është formuluar rregulli i fikhut: **Nuk duhet të mospranohen ndryshimet e ligjeve me ndryshimin e kohëve.** (Mexhele, 39)

Ibn Abdijni ka deklaruar se: “Duke pasur parasysh ndryshimin e traditave me ndryshimin e kohëve, atëherë edhe dispozitat ndërtohen me traditën e ndryshuar.”³⁶

Faktorët ndryshues mund të jenë ose çrregullues (denigrues) ose zhvillues, që do të thotë shkatërrojnë moralin dhe zhvillimin e mënyrës jetësore³⁷ dhe shembuj të kësaj janë si në vijim:

– Dijetarët e mëvonshëm e kanë lejuar pranimin e pagës për t'ua mësuar Kur'anin tjerëve, pranimin e pagës nga imami, muezini dhe për adhurime tjera siç janë namazi, agjërimi, haxhi, e kjo dispozitë është në kundërshtim me mendimin të cilin e kanë dhënë dijetarët e mëhershëm, prej tyre imamët e mëvonshëm e kanë shikuar krijimin e rrethanave sepse më herët iu është stopuar paga prej arkës qendrore për dijetarët dhe aktivistët për çështjet kryesore fetare, mirëpo po të angazhoheshin këta në bujqësi, tregti apo industri do të humbej vlera e Kur'anit dhe do të paralizoheshin çështjet themelore islame.

– Ndëshkimin e punëtorëve kolektiv si f.v., rrobaqepësi dhe ngjyruesi. Esenciale është se ata janë të besueshëm deri sa mos të tejkalojnë kufijtë apo të neglizhojnë, pastaj disa prej sehabëve si Umeri, Aliu dhe disa fukaha kanë vendosur të ndëshkohen duke marrë parasysh dëmtimin në duart e tyre dhe për të siguruar pasurinë e njerëzve.

– Pamjaftueshmëria e vetëm cilësisë së drejtësisë vetëm nga ana e jashtme për dëshmitarin. Ebu Jusufi dhe Muhamedi kanë dhënë mendim se patjetër duhet që dëshmitarët të jenë të drejtë. Kjo nënkupton që dëshmitari të jetë i drejtë me qëllim që dëshmia e tij të jetë e vlefshme për shkak të besueshmërisë së tij. E gjithë kjo me qëllim që të sigurohen të drejtat e njerëzve dhe të mos shkelen të drejtat e tyre, duke e ditur se ky mendim

është në kundërshtim me mendimin e Ebu Hanifes, i cili si kusht të dëshmisë e parasheh cilësinë e drejtësisë vetëm në vepra penale të përcaktuara dhe të papërcaktuara dhe nuk e ka kushtëzuar cilësinë e drejtësisë pasi që në kohën e tij ka dominuar drejtësia në shoqëri sepse ai ka jetuar në epokën për të cilën peygamberi s.a.v.s. ka dëshmuar se do të ketë mirësi,³⁸ mirëpo duke pasur parasysh ndryshimin e kohës në të cilën është përhapur gënjeshtria, atëherë dy studentët e tij kanë dhënë mendim të kundërt me mendimin e tij, pra, ka ardhur në pyetje ndryshimi i traditës.

– Imponimi për të dhënë deklaratë nga pushtetari. Ebu Hanife ka dhënë mendim se duhet të ketë imponim vetëm nga shteti, duke e parë si ka qenë gjendja në kohën e tij, sepse fuqi për të realizuar dhe penguar diçka ka pasur vetëm pushteti, mirëpo duke pasur parasysh ndryshimin e kohës dhe të gjendjes së shoqërisë dhe paraqitjen e padrejtësisë, dy studentët e tij kanë dhënë mendim se mund të bëhet imponimi edhe prej të tjerëve përpos pushtetit, duke u bazuar në atë çka kanë vërejtur në kohën e tyre.

– Ndalimi i grave të reja për të prezantuar në xhami me xhematë, e kundërta e asaj që ka qenë në kohën e peygamberit s.a.v.s.,³⁹ këtë mendim e kanë dhënë dy studentët e tij në bazë të asaj çka kanë vërejtur në kohën e tyre.

– Dijetarët Hanefijë kanë dhënë fetva se ndalohet që burri të udhëtoj me bashkëshorten e tij edhe nëse e jep mehrin e menjëhershëm për shkak të degjenerimit të shoqërisë. Po ashtu kanë dhënë fetva se nuk i jepet mehri bashkëshortes pasi që të ketë kontaktuar me të, pasi që nuk e ka pranuar kushtin që bashkëshortja ta ketë marrë menjëherë para kontaktit, sepse rregull i fikhut është **“I akuzuari mbrohet duke u betuar.”** Në këtë rast ky rregull është anashkaluar, se zakonisht (tradicionalisht) femra nuk e dorëzon veten e saj pa e marrë mehrin e menjëhershëm.⁴⁰

– Pranimi i 10 % të zekatit në bujqësi nga qiramarrësi e jo nga qiradhënësi. Kështu kanë dhënë fetva dy studentët sepse ka qenë më e pëlqyeshme në atë kohë dhe më praktike dhe më e dobishme për të varfrit sepse zekati merret nga fryti dhe shikohet pronari i frytit e ai pronar është qiramarrësi.

– Kjo dhe, edhe pse Ebu Hanife e ka paraparë që 10 % e zekatit të merret nga qiradhënësi sepse zekati është pasuri e pronarit e pronar është qiradhënësi i tokës.

– Kjo dhe shembujt tjerë siç janë: shitblerja VEFA⁴¹ dhe përdorimi i banjës pa u përcaktuar koha e qëndrimit dhe sasia e shfrytëzimit të ujit dhe

sanksionimi i baltës së rrugës në raste të domosdoshme. Dispozitat ndryshojnë me ndryshimin e traditës së banorëve të kohëve dhe të gjendjes së tyre.

– Hadithet e pejgamberit s.a.v.s. janë regjistruar në shek. e II me urdhrin e halifit Umer bin Abdul Azit r.a. pasi që në opinion është krijuar frikë se ata të cilët i mbanin përmendësh hadithet do të vdisnin dhe hadithet nuk do të ishin të siguruara (ruajtura) edhe pse pejgamberi s.a.v.s. në fillim kishte ndaluar shkrimin e haditheve që të mos përziheshin me Kur'anin, kur Muhamedi s.a.v.s. u ka thënë shokëve të tij: **“Kush ka shkruar nga unë përpos Kur'anit le ta fshijë atë.”**⁴²

Në ditët e sodit mjafton që te shitblerja e pasurisë së paluajtshme duke përshtuar numrin kadastral pa i përmendur katër këndet, nga shkaku se është themeluar libri kadastral sepse është bërë i panevojshëm përmendja e kufijve dhe merret parasysh vendimi gjyqësor për dorëzimin e pronës vetëm duke e regjistruar kontratën në librin kadastral, dhe me këtë bartet përgjegjësia e pronës vetëm duke regjistruar kontratën në librin kadastral, dhe me këtë bartet përgjegjësia e pronës nga shitësi te blerësi duke marrë për bazë zhvillimin dhe përparimin e metodave për t'u realizuar qëllimet, në vend se të bëhej dorëzimi i pasurisë së paluajtshme në vendin e ngjarjes e cila ka qenë e domosdoshme më herët.

3. Kur tradita kundërshtohet me kijasin, cila ka prioritet?

Nëse ndodh kundërshtimi i kijasit me traditën, janë pajtuar dijetarët se anashkalohet kijasi dhe i jepet përparësi traditës edhe pse tradita është më e re edhe nëse tradita është e përgjithshme sepse në të shumtën e rasteve tradita është argument i nevojshmërisë dhe është më i fuqishëm se kijasi dhe përkujdesja për të është interes i cili e plotëson nevojën,⁴³ e ai është istihsani në terminologjinë e Hanefijëve, sepse te ta istihsani është kijasi i fshehtë përballë kijasit të qartë dhe quhet të vepruarit me argument specifik prej tekstit ose ixhmait për të cilin janë pajtuar, ose të vepruarit praktik, ose të domosdoshëm ose të nevojshëm. Gjithashtu edhe te Malikijtë quhet **Istihsanë**.

Shembuj të kësaj natyre:

- Dispozita se është i pastër nga nevoja (glaca) e pëllumbit, kjo duke u bazuar në traditën e qëndrimit të tyre në xhami, bile edhe në Qabe, dhe anashkalimi me glacet e pulës.

- Dispozita e vlefshmërisë së aktit të qirasë me kusht të cilin nuk e parasheh kontrata duke vepruar vetëm me kushtet tradicionale duke e anashkaluar kijasin i cili e parasheh atë kusht në aktin e shitblerjes.

- Lejimi i huazimit të bukëve me numër të bukëve për shkak se fqinjët e kanë traditë edhe pse bukët kanë dallim në mes të tyre, kështu mendon studenti Muhamedi dhe anashkalimi i kijasit sipas mendimit të Ebu Hanifes dhe Ebu Jusufit për shitblerjen me porositje dhe paradhënie në të cilin akt ka dallim në sasinë dhe në prodhimin e bukëve në llojin e brumit, miellit dhe bukës. Kijasi anashkalohet nëse veprohet dhe praktikohet në bazë të mendimit të Ebu Jusufit se nuk lejohet pos nëse peshohet, sepse dallojnë bukët prej bukëve.

- Lejimi i shitblerjeve të vezëve dhe të bletëve për shkak të praktikumit të njerëzve dhe në bazë të mendimit të Muhamedit dhe anashkalimi i kijasit të kësaj në vendet e ndryshme të botës, si f.v., vezët e bretkosave.

- Pranimi i mehrit prej babës, respektivisht prej gjyshit, kur vajza e moshërritur dhe e virgjër nuk e ka babën, për shkak të zakonit dhe traditës për një mënyrë të tillë përderisa nuk ka ndonjë ndalesë për këtë dhe anashkalimin e kijasit sipas të cilit nuk lejohet pranimi i borxhit përpos prej personit ose prej të autorizuarit.

4. A llogaritet traditë tradita e cila është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të sheriatit?

Sipas mendimit të disa dijetarëve,⁴⁴ kur të realizohet tradita nuk është argument i pavarur sheriativ por është vetëm rregull fikhiye e tërësishme sepse në të shumtën e rasteve ato ndërtohen (themelohen) mbi bazën e realizimit të nevoja dhe interesit dhe të largimit të dëmit dhe të vështirësisë dhe lehtësimit të detyrave dhe se mbi të realizohen shumë rregulla të fikhut, si f.v., rregulli i njohur: “ligji i traditës në bazë të traditës është sikurse e kushtëzuara me kusht” dhe rregulli tjetër “të marrurit vendim në bazë të traditës është i njëjtë me të marrurit vendim me tekst”. Po ashtu rregulli tjetër: “Fjala e kuptimit të drejtë, anashkalohet ajo fjalë (në kuptim tjetër) me traditë apo me përdorshmëri tjetër.” etj.

Kur tradita bie në kundërshtim me rregullin e tërësishëm të fikhut, si f.v., rregullin e tërësishëm të fikhut si f.v., rregulli (parandalimi i të keqes) i bazuar në parimin: “Pikësnyimi i veprave merret për bazë dhe shikohet qëllimi i tyre.” ose me istihsanin ose me parimin e interesit atëherë kur nuk ekziston dispozita e cila mund të krahasohet me të, atëherë pasohet dispozita e mëparshme e cila ka qenë në kundërshtim me kijasin dhe anashkalohet rregulli i fikhut apo istihsanin apo parimi i interesit nëse tradita është traditë e përgjithshme për shkak të nevojës së përgjithshme dhe sigurimit të interesit të përgjithshëm dhe nga shkak se zakoni është ligj fuqiptotë, dhe kur njerëzit e marrin një çështje argument atëherë duhet të veprohet me të, dhe rregulli “interesi i përgjithshëm ka përparësi ndaj interesit të veçantë.” dhe rregullit “Tradita e zë vendin e ixhmait kur nuk ka tekst.”, kështu e ka përshkruar Ibni Hemami.⁴⁵

Nëntema e katërt: Rregullat e fikhut të cilat ndërlidhen me zakonin dhe traditën

Shkurtimisht do t'i paraqes rregullat të cilat kanë të bëjnë me zakonin dhe traditën.

Njëmbëdhjetë rregulla janë për traditën dhe zakonin, e ato janë:⁴⁶

1. Zakoni është ligj fuqiptotë.

Në këtë rregull, zakoni ngërthen në vete zakonin me llojet e tij siç janë: Zakoni shprehimor dhe zakoni veprues. Kuptimi i rregullit: Ligjvënësi i Urtë e ka paraparë zakonin që mbi të të bazohen dispozitat pa marrë parasysh a janë dispozita të përgjithshme apo të veçanta dhe e ka paraparë të jetë argument për të dispozituar kur nuk ka tekst dhe bazë në të cilën bazohen njerëzit në shpërndarjen e të drejtave dhe detyrat e tyre në mes tyre kur ata veprojnë në mes vete.

Pjesa e rregullit “fuqiptotë” e ka paraparë që ligji të jetë bazë ligjore dhe e ka bërë zakonin që të jetë mbështetje ligjore.

Ky rregull sqaron vendin (rolin) e zakonit dhe të marrurit si bazë ligjore në sheriatin islam.

2. Atë të cilën njerëzit e praktikojnë si argument, me të duhet të veprohet.

Ky rregull është brenda konceptit të rregullit “Zakoni është bazë ligjore fuqiplote.” dhe përfshin zakonin shprehimor dhe veprues dhe vendosja e dorës në një send dhe të vepruarit në të është argument pronësie. Pagesa e njeriut për të blerë një send me të njëjtin çmim i cili njihet në treg quhet shitblerje e vlefshme, nëse nuk e bën pagesën nuk është e vlefshme.⁴⁷

3. Zakoni merret për bazë kur bëhet zakon i rregullt ose praktikohet në të shumtën e rasteve.

Ky rregull tregon për një kusht të kushteve të zakonit e ai kusht është që veprimi të jetë i rregullt dhe në të shumtën e rasteve është kusht i rregullit “Zakoni është ligj fuqiplotë.”. Fjala “dërhem” merret për bazë për monedhën e dërhemit të cilën e përdorin banorët e vendit në të cilën bëhet kontrata, nëse zakoni ndryshon atëherë duhet të sqarohet, përndryshe kontrata shpallet e pavlefshme.

4. Merret për bazë e shpeshta dhe jo e rralla.

Ky rregull, po ashtu shpreh një kusht prej kushteve të traditës, e ajo është që veprimi të jetë i shpeshtë, e ka kuptimin e rregullit të mëhershëm.

Vitet e gjidhënies dhe gjidhënësja përcaktohet në bazë të asaj çka është e njohur dhe është zakon në vendin ku jetohet dhe aq sa është e mjaftueshme për fëmijën në ushqim, veshmbathje, pastrim, etj., dhe mjaftueshmëria që mosha e pjekurisë të jetë nëntë vite.

5. Anashkalohet fjala në kuptim të drejtë për shkak të tregueshmërisë së kuptimit zakonor.

Ose, anashkalohet fjala në kuptim të drejtë me tregueshmërinë e përdorimit të po asaj fjale.

Ky rregull është posaçërisht për traditën shprehimore dhe do të thotë: “Nëse një fjalë përdoret në kuptimin e saj jo të drejtë kur të thuhet, atëherë asaj thënie i jepet kuptimi i traditës e jo i kuptimit të saj të drejtë.” Përdorimi më i shpeshtë i këtij rregulli bëhet nga tradita e posaçme e profesionistëve të një profesioni, ata i kanë terminologjitë e tyre të veçanta,

po ashtu edhe traditat krahinore. Kush e blenë një bukë, atëherë merret për bazë sipas përdorimit të kontratave të atij vendi, si f.v., buka e Sirisë, ose e Egjiptit, ose buka e grurit.

6. Të shkruarit është si të shprehurit.

Ky rregull tregon për njërën prej bazave të traditës shprehimore e cila nënkupton se shkresa tradicionale e zë vendin e fjalimit të drejtpërdrejtë.

7. Shenjat e shurdhmemecit janë sikurse t'i ketë sqaruar me fjalë.

Ky rregull, po ashtu ka kuptimin e rregullit të mëhershëm dhe shenjat të cilat kuptohen nga shurdhmemeci e zënë vendin e sqarimit të folësit dhe mbi këtë rregull fukahatë përpilojnë dispozita në sqarimin e qëllimit të kontratave sepse shenjat e shurdhmemecit tregojnë qartë qëllimin e tij, mjafton në fuqizimin e kontratës, qoftë ajo kontratë kontratë e shitblerjes apo e kurorëzimit, mirëpo shenjat e shurdhmemecit nuk merren parasysht në fuqizimin e veprave penale të përcaktuara (hududë) sepse veprat penale të përcaktuara (hududë) nuk fuqizohen me dyshime.

8. E përdorura në traditë është sikurse e kushtëzuara me kusht.

Kuptimi i këtij rregulli: Ajo çka vendoset nëpërmjet rrugës së traditës është sikurse e kushtëzuara me ndonjë kusht dhe përfshinë gjithë njerëzimin. Ai i cili ka mosmarrëveshje me kontraktuesin tjetër për mënyrën e shfrytëzimit të sendeve me qira apo të huazuara, zgjidhja në mes tyre bëhet në bazë si e parasheh qëllimin e shfrytëzimit tradita praktike.

9. Identifikimi me traditë është sikurse identifikimi me tekst.

Edhe ky rregull, ka kuptimin e rregullave të mëparshme. Atë të cilin nuk e parasheh teksti i shariatit dhe nuk është përmendur (nënvizuar) në kontratë në mënyrë të qartë, merret vendim në bazë të traditës të cilën e praktikojnë njerëzit e atij vendi dhe që është e ditur në mes tyre dhe ashtu identifikimi me atë traditë është sikurse të jetë identifikuar me tekst. Kjo mund të determinohet me formulë tjetër. Vendimi me traditë është sikurse të jetë marrë vendim me argument të shariatit.

10. E njohura (tradita) e tregtarëve në mes vete është sikurse kushtëzimi mes tyre.

Kuptimi i këtyre dy rregullave është i njëjtë me dy rregullat e mëparshme, vetëm se këtu kemi të bëjmë me traditën e veçantë e cila është bërë traditë në mes të tregtarëve të një profesioni të caktuar dhe të një vendi të caktuar. Kjo traditë praktike është fuqiplote sikurse tradita e përgjithshme, mirëpo përkufizohet vetëm te ata të cilët e praktikojnë atë traditë dhe jo tek të tjerët.

11. Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave në bazë të ndryshimit të kohëve.

Për këtë rregull kemi shpjeguar më herët, për fushën e saj, dhe kam ilustruar me shembuj dhe kuptimi i saj është: Dispozitat e ndërtuara nga tradita ndryshojnë me ndryshimin e traditës mbi të cilën është ndërtuar sepse dispozita sillet me arsyen, kur mungon arsyeja mungon dispozita dhe anasjelltas, kur ekziston arsyeja ekziston edhe dispozita. Nëse bëhet traditë që të paguhet mehri para kontaktit dhe pastaj ndryshon tradita e cila lejon që një pjesë e mehrit të jetë i menjëhershëm dhe një pjesë tjetër pas një afatizimi, atëherë veprohet me traditën e re dhe anashkalohet tradita e menjëhershme.

Shembuj praktik të traditës

Këtu do t'i përmendi disa shembuj të rëndësishëm të cilat kanë lidhje me jetën praktike (me traditën):⁴⁸

- Marrja e vendimit sipas traditës se mobilia e shtëpisë së blerë para kurorëzimit është e bashkëshortes, nuk i merret parasysh pretendimi se është pronësi e burrit deri sa të vërtetohet e kundërta.

- Në blerje të shtëpisë bën pjesë edhe pjesa e lartë (kulmi) edhe pse kjo nuk përfshihet në kontratë sepse këto janë pjesë dhe e drejtë e blerësit të banesës, e kjo bazohet në traditë. Parapagesa prodhuese është kontratë legjitime edhe sipas sheriatit edhe sipas traditës për shkak të nevojës së njerëzve edhe pse është shitblerje inekzistente.

- Malikijët dhe dijetari i umetit Halvaniju, Hanefijët, e kanë lejuar shitblerjen e pemëve dhe perimeve kur një pjesë prej fryteve ka filluar të piqet, si f.v., shalqiri, domatet, rrushi, e të ngjashme, duke u bazuar si çështje e domosdoshme në traditë edhe pse një pjesë e shitblerjes është shitblerje inekzistente.

- Në lidhje me këtë çështje kanë kundërshtuar Shafijët dhe Hanbelijët dhe sipas një mendimi edhe Hanefijët.

- Ibn Abidijnë ka dhënë fetva për lejin e kësaj shitblerje.

- Blerja e disa artikujve siç janë: orët, televizorët, frigoriferët, me garancion të riparimit nëse priset e jo nëse thyhet në kohë të caktuar pa pagesë. Kjo është e lejuar duke u bazuar në traditë përkundër ekzistimit të hadithit: **“Ka ndaluar pejegamberi s.a.v.s. kushtëzimin për shitblerjen.”**⁴⁹ dhe e cila është në kundërshtim me kijasin. Hanefijët e kanë lejuar në librin e kushteve. E vërteta është se tradita nuk është në kundërshtim me hadithin por me kijasin, siç e ka shpjeguar Ibn Abidijni⁵⁰ sepse hadithi e arsyeton në rast të paraqitjes së mospajtit i cili mund ndikoj që akti të mos ketë efekt në realizimin e qëllimit, e hadithi parandalon ato mospajtime, ndërsa tradita është po ashtu pengues i mospajtimeve dhe kështu është në përputhshmëri me hadithin dhe nuk mbetet pengesë përpos kijasit, ndërsa tradita favorizohet ndaj kijasit.

- Shprehjet e vakëflënësve ndërtohen në bazë të traditës së tyre të kohës në të cilën kanë jetuar.

- Muhamed bin Hasani r.a. e ka lejuar lënien e vakëfit për sende të patundshme nëse njerëzit e bëjnë traditë këtë edhe pse është në kundërshtim me mendimin e Ebu Hanifes se “natyra e vakëfit është e përgjithmonshme”.

- Obligueshmëri e DIJES për vrasjen e paqëllimtë për familjen e ngushtë dhe kjo në bazë të traditës arabe edhe pse logjikisht vrasësi duhet të jetë ai i cili duhet të paguajë sepse ai është kryerësi i veprës.

- Në martesë në mes bashkëshortëve duhet të ketë barazi, edhe kjo bazohet në traditën arabe edhe pse të gjithë njerëzit janë të barabartë. Kjo për të siguruar ardhmërinë e bashkëshortëve sepse zakonisht njerëzit dallohen prej tjerëve.

Nëntema e pestë: Kundërshtimi i traditës me thënien e dijetarëve (fukahave)

Kjo temë përmban tri çështje:

1. Te Hanefijtë, a anashkalohet transmetimi i një mendimi kur tradita bie në kundërshtim me të?

Kur tradita bie në kundërshtim me traditën (transmetimi prioritarë është bazë në drejtimin Hanefit) dhe sipas medhhebit transmetimi i dobët është në përputhshmëri me traditën. A anashkalohet transmetimi i paraqitur në ato kohëra?

Disa dijetarë Hanefijë si f.v., autori i librit “Kunijeti” mendojnë se as muftiu, as kadiu, nuk lejohet të gjykojnë në bazë të drejtimit sipërfaqësor dhe të anashkalojnë traditën. Kjo bie në kundërshtim me deklarimin e dijetarëve Hanefijë se, nëse transmetimet janë prej librave të transmetimeve të qarta nuk anashkalohen pos nëse dijetarët e hadithit nuk saktësojnë një transmetim tjetër sepse transmetimi i qartë ndonjëherë mund të bazohet nga qartësia e Kur’anit, sunetit apo ixhmait, kështu nuk merret parasysh tradita e cila bie në kundërshtim me tekstin sepse është e mundur që tradita të jetë e pavlefshme përballë tekstit ashtu siç ka thënë Ibni Hemami.

Në librin “El-Ishbah” Ibni Nexhijmi ka thënë: “Tradita nuk merret për bazë për një çështje kur ajo çështje veç është tekstualizuar.”⁵¹

Mirëpo Ibni Abidijni në “Risalen” e tij i ka dhënë prioritet traditës nëse ajo traditë bie në kundërshtim me transmetimin e qartë, kur thotë: “Muftiu nuk duhet të jetë i ngurtë në transmetimet e librave me transmetime sipërfaqësore pa pasur njohuri për kohën e njerëzve në të cilën kanë jetuar sepse kështu humbë shumë të drejta dhe dëmi i tij është më i madh se dobia.”⁵² Përderisa mendimi i dijetarëve të mëhershëm Hanefijë ishte: “Atëherë kur tradita nuk bie ndesh me transmetimin sipërfaqësor, përderisa nëse bie ndesh me diçka tjetër duhet të anashkalohet sepse atëherë është mendim i dijetarit të atij drejtimi dhe në bazë të rregullave të tij.”

Dijetarët e mëvonshëm Hanefijë e favorizojnë drejtimin i cili i jep prioritet traditës e prej tyre, Ebu Hanife dhe Ebu Jusufi kanë thënë: Pasuria e paluajtshme nuk mund të uzurpohet, për këtë arsye nuk ndëshkohet nëse e shkatërron, mirëpo Muhamedi, Zuferi dhe tre studentë tjerë e kanë kundërshtuar dhe mendimi i këtyre është më prioritar edhe pse kanë dhënë fetva për këtë në pasurinë e paluajtshme të jetimit dhe të vakfit sepse ashtu sigurohet pasuria e tyre që të mos humbë dhe të mos përbuzet.

Ebu Hanife dhe dy studentë të tij kanë dhënë fetva se dënohet qiraxhiu i përbashkët nëse shkatërrimi është bërë edhe pse ka mundur ta parandaloj, kjo për shkak të ndryshimit të aftësive njerëzore sepse ndryshe nuk mund të sigurohet pasuria e njerëzve. Ky mendim është në kundërshtim me mendimin e dijetarëve të mëvonshëm Hanefijë sepse japin mendim të kundërt me mendimin e Ebu Hanifes, Zuferit dhe të Hasan bin Zijadit, sepse dijetarët e mëvonshëm thonë se nuk dënohet qiraxhiu i përbashkët nëse shkatërrohen sendet tek ai, pa marrë parasysh a ka pasur mundësi të parandaloj apo jo, si f.v., vjedhja e gjësendeve apo edhe djegia e tyre.

- Hanefijtë japin fetva sipas mendimit të dy studentëve, se lejohet kontrata “MUZAREAT” (kontratë e agronomisë-koncesioni i plantacionit) i cili është në kundërshtim me argumentimin e Ebu Hanifes, të cilët thonë se: “Sot merret parasysh fetvaja e dy studentëve sepse njerëzit e praktikojnë një kontratë të tillë.”, bile ibn Abidijni sjell thënien në të cilën thuhet se merret për bazë tradita e veçantë edhe nëse kundërshtohet me tekstet e librave të medhhebit përderisa nuk bie në kundërshtim me tekstet e sheriatit. Si mund të thuhet: Absolutisht nuk merret për bazë tradita e veçantë kur dihet se çdo mendimtar ka për qëllim atë që e kanë traditë njerëzit.⁵³

Kerafiu e përkrash këtë mendim: “**Ngurtësimi vetëm në transmetime është humbje në fe dhe injorancë ndaj pikësnyimit të dijetarëve islam dhe dijetarëve të mëhershëm.**”⁵⁴

2. A veprohet në bazë të një medhhebi, të medhhebi tjetër i cili është në përputhshmëri me traditën dhe a konsiderohet kjo anashkalim medhhebi apo i takon llojit të ndryshimit të dispozitës në bazë të ndryshimit dhe traditës?

Mendimi që prinë është pavarësia ndaj medhhebeve, mirëpo kundërshtimi ka të bëjë me aspektin edukativ dhe nëse ekziston traditë e cila është në përputhshmëri me vendimin e një medhhebi tjetër, veprohet me traditën, nëse ajo traditë është e përgjithshme edhe nëse kundërshtohet me argument legjislativ, nëse nuk kundërshtohet me argument legjislativ, atëherë tradita e anashkalon tekstin e fikhut pa marrë parasysh ajo traditë a është traditë e përgjithshme apo e veçantë, si f.v., formulimet e detyrimeve dhe fakteve të mënyrave zakonore dhe rregullat për të cilat nuk ka tekst të artikujve të kamatës.

Nga kjo rezulton se në medhhebin Hanefijë definohej se: Përderisa nuk precizohet, pagesa është e lirë të paguhet, dhe për këtë arsye Ibni Nexhimi në librin “**El-Ishbah**” ka thënë: Nëse një tregtar blen një send me një çmim dhe nuk janë marrë vesh për kohën e pagesës dhe të mospagesës, ndërsa ka qenë traditë që tregtarët në mes vete të pastrohen (të kryejnë pagesat në mes vete) çdo të enjte apo çdo të premte, atëherë merret për bazë kjo ditë pa qenë e sqaruar sepse e praktikuara në traditë është sikurse e kushtëzuara me kusht.

3. Ndryshimi i dispozitës i ndërtuar prej ndryshimit të traditës, a është obligativ apo i lejuar apo jepet fetva në bazë të dijetarëve të mëhershëm?

Nga mendimet e dijetarëve u kuptua se në argumentimin e fikhut se muftiu apo kadiu duhet të veprojë me traditën e re e cila i ka plotësuar kushtet për t'u marrë si bazë ligjore dhe e anashkalon traditën e vjetër. Nuk jep fetva në bazë të fekihut të vjetër i cili është në kundërshtim me traditën momentale sepse dispozita është në rotacion me arsyen, nëse ekziston arsyeja, ekziston dispozita, dhe nëse nuk ekziston arsyeja, nuk ekziston dispozita, dhe realizon interesin dhe plotëson nevojat.

Edhe më herët treguam thënien e Karafijut: “Ngurtësimi me vetëm transmetimin është humbje në fe dhe injorancë ndaj pikësnyimit të dijetarëve islam dhe dijetarëve të mëhershëm.”⁵⁵

Ibn Kadijmi ka thënë: “Çdo çështje e cila kalon prej drejtësisë në padrejtësi, prej mëshirës në pamëshirë, prej dobisë në dëm, prej urtësisë në përbuzje, ajo nuk është prej sheriatit, edhe nëse në ato çështje bëhen interpretime.”⁵⁶

Nga ajo që sqaruam kuptohet se të vepruarit me traditën konsiderohet si ilustrim i qartë i fleksibilitetit të dispozitave të sheriatit islam dhe frytdhënies së fikhut islam e cila zë vend në kohën bashkëkohore në llojet e ligjeve ndërkombëtare dhe moderne.

Fusnotat:

1. “Silmul vusulë ila ilmil usulë”, 217.
“El-mustesfa”, 2/138, El-Gazaliu.
“Resailu Ibni Abidijn”, 1/186, 2/12.
2. “Sherhut-tekrirë”, 2/114.
3. “El-Eshbau ven-nedhair”, 93, Ibni Nexhimi.
“Sherhuz-Zehaviju lil menarë”, 423.
“Resail Ibni Abidijn”, 2/12.
“El-mustesfa fil fikhi”, En-Nesefiu, botues “Darul Kutubul misrijeti”.
4. “Keshful Esrarë”, 2/96-98.
“Et-Telvijh alet Tevdijh”, 1/175.
5. “Et-Tekrirë vet-Tehbirë”, 1/182.
“El adetu vel urf fi reëjil fukahae”, 10-12, autor Ebi Seneti.
6. “El-med-hal fikhil amë”, 476, prof. Mustafa Zarka.
7. “Nedharijetul urf”, 21, Abdul Azizë Hajjat.
8. “El-Eshbau ven-Nedhairu”, 92, Sujutiu.
“El-med-hal fikhil amë”, 486-490, prof. Mustafa Zarkaë.
9. “Resailu Ibni Abidijn”, 2/110.
10. “El-muvafekat”, 2/209.
11. Zejleiju në librin “Nasburr-Rrajeti” për këtë ka thënë garibë merfuë. Nuk e kam hasur askund përpos mevkuf te Ibni Mes’udi. Ky hadithë ka tri drejtime:
Drejtimi i parë: Transmeton Ahmedi në musnedin e tij.
Drejtimi i dytë: Transemtion Ebu Davud et-Tajalisiu.
Drejtimi i tretë: Transmeton el-Bejhekiju.
12. Transmeton një numër autorësh përpos Tirmidhiut. (“Nejlul evtarë”, 7/136).
13. “El-muvafekatë”, 2/212.
14. “El-urfu vel adeti fi reëjil fukahae”, 32-39, shejh Ahmed Fehmi Ebu Seneti.
15. Es-Selm – blerja e menjëhershme për më të vonshmen.
urja – shitblerja e hurmave të thata me hurma jo të thata nën shumën e pesë evsakëve (653 kg.)
16. “El muvafekat”, 2/206.
17. Ibid, 2/211.
18. “Fet’hul kadirë”, 2/157.
19. “El-med=hal fikhil amë”, fq. 493, prof. Zarka.
“El-urfu vel adeti”, 54, Ebi Seneti.
20. Karafiu ka thënë: Tregueshmëria e fjalës zakonore ka përparësi ndaj fjalës në kuptim të drejtë sepse zakoni e shfuqizon fjalën gjuhësore, kështu që shfuqizuesi ka përparësi nga e shfuqizuara dhe sikurse kontrata e shitblerjes bëhet me monedhat e zakonshme. Në atë shitblerje nuk llogaritet shitblerja e ndryshimit të zakonit më pastaj me monedha tjera. Kështu është edhe me tekstet e sheriatit, nuk ndikon në të përpos me atë që krahasohet me zakonet. (“Tenkihul fusulë”, 143, El-Karafiju.
21. “El-ihkam fi temjizil fetava anil ahkam ve tesarrufatil kadi vel imam”, 73.

22. "Resail Ibni Abidijn", 5/115.
23. "El-med-hal fikhi", 492, prof. Zarkaë.
24. "Resailu Ibni Abidijn", 2/116-13.
- "El-Eshbahu ven-nedhairu", 86, Es-Sujutiu.
25. "Resailu Ibni Abidijn", 2/121-132.
26. Ibid, 2/132.
27. "El-urfu vel adeti fi reëjil fukahaë", 58-61.
- "El Eshbau", 41, Ibn Nexhijm.
28. "Reddul muhtarë", 4/41.
29. "El-med-hal fi fikhil ameti", 503-507, prof. Zarkaë.
- "El urfu vel Adeti", 56-68, Ibni Seneti.
- "El-Eshbahu ve nedhairu", 101, Ibni Nexhijmi.
- "El Eshbahu ve nedhair", 96, Es-Sujutiju.
30. "El-Eshbahu ve nedhairu", 87.
31. "Fevatihu Rahmutë", 1/345.
- "El Furukë", 1/171, El Karafiju.
- "Sherhul Esnefij", 2/128.
- "El Urfu vel adeti", 90-101, Ebij Seneti.
- "El-med-hal fikhi", 516-563, prof. Zarkaë.
32. "Hashijetu Dusukiju ala sherhul kebirë", 2/143.
33. "El-muvafekat", 2/283, Esh-Shatibiju.
- "El-med-halul fikhi", 51-513, Zarkaë.
34. "El-eshbahu ven-nedhairu", 112, botimi Darul Fikri – Damask.
35. Transmetojnë pesë koleksionistët përpos Nesaijut. Hadithin e ka saktësuar Tirmidhiu nga Enesi. ("Nejlul Evtarë", 5/219).
36. "Resailu Ibni Abidijn", 2/125.
37. "El-med-halul fikhi", 541-555, Zarkaë.
38. E ka regjistruar Buhariu dhe Muslimi nga Imran bin Husejni r.a. i cili ka thënë: Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: Gjenerata më e mira është gjenerata me mua, pastaj të tjerët pas tyre dhe pastaj gjenerata pas tyre. ("Subules-selam", 4/136).
39. Nga Umi Selmete transmeton Ebu Davudi, Nesaiju dhe Buhariu se pejgamberi s.a.v.s. kur jepte selam qëndronte në anë të majtë të vendit të vet (Zoti e di më së miri) ashtu që gratë të shpërndahen para burrave, ashtu që burrat të mos i arrinin ato. (Transmeton Ahmedi, Taberaniu, Bejhekiu nga Umi Hamidë: Namazi i juaj në shtëpitë tuaja është më i vlefshëm se namazi me xhematë në xhami. "Xhem'ul fevaïd", 1/239).
- Ahmedi në musnedin e tij transmeton ashtu siç transmeton Muslimi nga Ibni Umeri: Mos i ndaloni robërshat e Allahut të falen në shtëpitë e Allahut.
40. "Resail Ibni Abidinë", 2/126.
41. Shitblerja vefaë – është shitblerja e të hollave me pasuri të paluajtshme për shkak nevoje, ashtu që kur t'ia jep të hollat ia kthen pasurinë e paluajtshme.
42. Transmeton Muslimi në Sahihun e tij. ("Sherhul muslim", 18/129, En-Nevij).
43. "Resail", 2/116, Ibni Abidijn.
- "El Urfu vel adetu", 101-103, Ebi Senete.
- "El-med-hal fikhil ameti", 53-532, Zarkaë.

44. "Usulul fikhi", 102, Abdul Vehab Halaf.
45. "Fet-hul kadirë", 2/57.
46. "El-eshbahu ven-Nedhair", 80-90, Sujutiju.
- "El-eshbahu ven-nedhair", 101-112, Ibni Nexhim, boton Darul Fikri – Damask.
- "El-med-hal fikhij", 604-614, prof. Zarkaë.
- "Nedharijetul urfi", 94-102, Abdu Aziz el-Hajatë.
47. "Sherhul Mexhelete", M/37, prof. Ali Hajderi.
48. "Resailu Ibni Abidijn", 2/121-134.
49. Transmeton Ahmedi dhe koleksionistët e suneneve, e ka saktësuar Tirmidhiu, Ibn Huzejme dhe Hakimi nga Amr bin Shuajbi e ai nga babai, e babai i tij nga gjyshi se: Pejgamberi s.a.v.s. e ka ndaluar shitblerjen dhe kushtin, ashtu që edhe kushti është i pavlefshëm edhe shitblerja është e pavlefshme. "Nasbu Rrajeti", 4/17; "Subules-selam", 3/16.
50. "Resailu Ibni Abidijn", 2/121.
51. "Resailu Ibni Abidijn", 2/115.
52. Ibid, 2/121.
53. Ibid, 2/130-133.
54. "El furukë", 1/177.
55. "El furukë", 1/177.
56. "Iëlamul mukiijnë", 3/14, Muhjid-dijn Abdul Hamidë.

Përmbajtja:

<i>Tradita</i>	4
Nëntema e parë: Esenca e traditës dhe zakonisht dhe llojet e tyre.....	5
1. Definicioni i traditës gjuhësisht dhe terminologjisht.	5
2. Definicioni i zakonisht gjuhësisht dhe etimologjisht.....	6
3. A ka dallim në mes të traditës dhe zakonisht, dhe nëse ka, cili është ai dallim?.....	6
Burimi i zakonisht dhe traditës.....	8
1. Dallimi në mes të traditës dhe ixhmait.....	8
2. Tradita nga aspekti i përmbajtjes.	9
3. Tradita nga aspekti i realizimit.....	10
4. Tradita e vërtetuar me ligj ose varësisht prej pranimit apo mospranimit të tij.	11
Nëntema e dytë: Kur llogaritet tradita si traditë dhe llojet e saj.....	12
Vlera apo fuqia e traditës tek fukahatë	12
1. Argumentet të cilat e bëjnë që tradita të llogaritet si burim.	13
2. A ndikon tradita e shprehjeve në ligjet e shariatit.	17
3. A merret parasysh tradita vepruese në ligjet e shariatit?	18
4. A duhet të llogaritet tradita si traditë e veçantë dhe e përgjithshme së bashku apo vetëm traditë e përgjithshme?.....	20
5. Si e llogarit shumica absolute e dijetarëve traditën e veçantë?	21
Nëntema e tretë: Kushtet e pranimit të zakonisht dhe të traditës dhe rrugës së prioritetit të tyre kur janë në kundërshtim me tekstet e shariatit	23
1. Cilat janë kushtet për t'u marrë për bazë tradita?	23
2. Çfarë ndikimi kanë traditat në tekstet e shariatit?	29

3. Kur tradita kundërshtohet me kijasin, cila ka prioritet?.....	32
4. A llogaritet traditë tradita e cila është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të sheriatit?.....	33
Nëntema e katërt: Rregullat e fikhut të cilat ndërlidhen me zakonin dhe traditën	34
Shembuj praktik të traditës	38
Nëntema e pestë: Kundërshtimi i traditës me thënien e dijetarëve (fukahave).....	39
1. Te Hanefijtë, a anashkalohet transmetimi i një mendimi kur tradita bie në kundërshtim me të?.....	39
2. A veprohet në bazë të një medhhebi, të medhhebi tjetër i cili është në përputhshmëri me traditën dhe a konsiderohet kjo anashkalim medhhebi apo i takon llojit të ndryshimit të dispozitës në bazë të ndryshimit dhe traditës?	41
3. Ndryshimi i dispozitës i ndërtuar prej ndryshimit të traditës, a është obligativ apo i lejuar apo jepet fetva në bazë të dijetarëve të mëhershëm?.....	42

